5 nuk përdoren dot rrugë të tjera, atëherë të mbetet që të
6 dalësh publikisht.

7 Py. Pra eksplorimi i efektivitetit të kanaleve të tjera do të
8 ishte diçka e cila do të ishte e justifikueshme për të dalë
9 publikisht apo e kam gabim?

10 Pë. Keni të drejtë, po, varet nga sesa - duhet ta mendosh në
11 mënyrë të arsyeshme se cilat fusha janë dhe çfarë rrugësh
12 Këshilli Evropian në dispozicion.

13 Py. Do t'i kthehemi "besimit të arsyeshëm" pas pak. Por
14 besimi i arsyeshëm, a është ky një faktor që duhet mbajtur
15 parasysh kur merret ky vendim personal.

16 Pë. Po.

17 Py. A mund të shpjegoni se për çfarë e keni fjalën kur në
18 paragrafin 19 të raportit tuaj ju përmendni sinjalizues me
19 ndërmjetësues?

20 Pë. Është interesante. Është pjesë e kësaj fushe aty ku
21 mundësitë përmes të cilave njerëzit mund t'i ngrenë
22 shqetësimet e tyre me kalimin e viteve në terren ka ndryshuar
23 dhe njerëzit në dallim nga ç'kanë pasur në dispozicion
24 njerëzit pra 20-30 vjetësh tani i kanë më pak mundësitë.

25 Kështu që ngrihet pyetja kush është objektivi sepse mund

1 të ketë ndryshuar dhe objektivi i informacionit. Njerëzit të
2 cilët i mbështesin sinjalizuesit apo organizatat në veçanti në
3 fushën time, pra në organizatat a shoqërisë civile
4 jofitimprurëse, të cilat kanë informacione, gjithnjë e më
5 shumë ato po vihen në shënjestër sepse sinjalizuesit dhe
6 individët, të cilët janë të shqetësuar mund të ndihen se nuk i
7 kanë pozitativat e forta. Kështu që u drejtohen organizatave të
8 shoqërisë civile. I drejtohen edhe shtypit, u drejtohen
9 gazetarëve. Gazetarët pastaj kanë detyrimin për të ruajtur
10 konfidencialitetin e burimit, që është i përkufizuar më i
11 qartë në rastin e tyre. Por OJQ-të janë shumë të kujdesshme -
12 nga përvoja ime për shembull - në fushën tonë po e kuptojnë
13 edhe më shumë që tani janë objektivi dhe po punojmë së bashku
14 për t'a kuptuar që nuk janë të vetme. Kështu që ato bëhen
15 ndërmjetësuese, sepse e marrin ato informacionin dhe kështu me
16 ndërmjetësim bëhen dhe objekt i hakmarrjes.

17 Py. Kur është përcaktuar ky përkufizim që ju përmendët, cilit
18 burim do t'i drejtoheshit? Në paragrafin 21 të raportit tuaj
19 mund ta gjeni përgjigjen.

20 Pë. Sa i takon burimit, burimi është përvoja ime në terren.
21 Por ka dhe burime zyrtare. Raporti më i fundit i Asamblesë
22 Parlamentare, reporteri për këtë ishte Sylvain Wasserman, një
23 deputet francez dhe Komisioni për Çështjet Juridike dhe të
24 Drejtat e Njeriut është shprehur - i ka kërkuar Komitetit të
25 Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare që të përcaktojë se kush

1 janë pra sinjalizuesit dhe që mbrojtja e sinjalizuesve duhet
2 të përfshijë dhe mbrojtjen e ndërmjetësuesve.

3 Py. Para se të kalojmë tek parimet e përgjithshme apo te
4 kriteret e përgjithshme, kur bëhet përcaktimi nëse një
5 nxjerrje e informacionit duhet mbrojtur apo jo deri ku personi
6 që kërkon ta nxjerrë këtë informacion publikisht duhet që të
7 verifikojë, deri kur duhet ta verifikojë pra saktësinë e këtij
8 informacioni?

9 Pë. Shumë varet nga mënyra sesi kanë ardhur në dijeni të
10 këtij informacioni. Edhe kjo është një gjë që nga ana ligjore,
11 juridike ka marrë shqyrtim, për shembull në ligjet e mëparshme
12 në Britani është përdorur "mirëbesimi" fjala "mirëbesim" - pra
13 që duhet ngritur një shqetësim publik në mirëbesim. Dhe për
14 shumicën e juristëve mirëbesimi do të thotë se e ke bërë me
15 ndershmëri, me sinqeritet, jo se s'ke bërë gabime, jo se je
16 ekspert edhe se ke bërë analizë.

17 Për fat të keq, në gjykatat e posaçme të punës, kjo është
18 përdorur për të bërë një - pra ka pasur një diskutim të gjatë
19 sa i takon motiveve të sinjalizuesve - pra të cilët janë
20 motivet e individit, të cilët pastaj janë përdorur dhe si
21 stekë krahasimi, si standard për ta krahasuar edhe se cilët
22 janë interesat e sinjalizuesve publikë.

23 Nëse informacioni i interesit publik shkon në vendin e
24 duhur, ideja është që mund të fokusohesh tek individi duke
25 cenuar ligjin edhe pse një gjykatë në Guja në vitin 2008 e

1 vendosi se një prej kushteve që duhet shqyrtuar nga gjykatat,
2 e vendosi si precedent - edhe unë këtë dua t'jua them edhe
3 juve se është e rëndësishme që të mbahet parasysh nëse
4 mirëbesimi është hequr nga instrumentet ligjore.

5 Pra ky është një rekomandim i Këshillit të Evropës që
6 duhet kërkuar, që duhet pasur arsye për të besuar tek e
7 vërteta e informacionit me aq sa mund të dije ti në atë kohë.
8 Direktivat e Bashkimit Evropian në mënyrë të ngjashme nuk e
9 kanë përfshirë mirëbesimin gjithashtu, pra është përjashtuar
10 mirëbesimi.

11 Py. Pra këtij individ nuk do t'i kërkohej që të kryente një
12 analizë të gjerësishme? Nëse ky person ka pasur besim të
13 arsyeshëm se ky informacion ka qenë i mjaftueshëm?

14 Pë. Po, këtë e shikojnë gjykatat.

15 Py. Dua të shoh tani paragrafin 28 e tutje.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, zonjusha Myers
17 përmendi - Guja është një çështje gjyqësore që përmendet në
18 paragrafin 26 me numër DNH0357, [sipas përkthimit], DNH0388.
19 Nuk kam ndërmend që t'i shikoj me hollësi këto, por thjesht
20 për referencë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. CADMAN: [Përkthim]

23 Py. Cilat janë kriteret apo parimet që përdoren për të
24 përcaktuar nëse duhet mbrojtur apo jo një nxjerrje publike
25 informacioni?

1 Pë. Siç e përmenda më përpara, vendimi në çështje Guja është
2 në nivel të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
3 Pastaj ka edhe në nivele të ndryshme. Në nivel të
4 legjislacioneve të brendshme të vendeve të ndryshme, është
5 eliminuar kriteri i mirëbesimit. Në përgjithësi ajo çfarë ka
6 bërë GJEDNJ-ja dhe këtu mbështetem tek përvoja ime - për shkak
7 të përvojës time unë mbështetem tek sistemi britanik - por
8 nxjerrja publike e informacionit shikohet nga disa aspekte, të
9 cilat pastaj do të përcaktonin nëse duhet mbrojtur apo jo
10 personi. Kjo ka të bëjë me rëndësinë e informacionit, cenimin
11 e interesit publik, por kësaj do t'i kthehem më mbrapa.

12 Por po të shohim dua të kujdesem që i kam në rendin e
13 duhur faqet. Ne kemi diskutuar më herët. Folëm përpara nëse
14 sinjalizuesi, individi ka apo jo kanale alternative dhe sa
15 efektive dhe të arritshme janë këto kanale për këtë individ,
16 po kështu interesi publik për informacionin. Por Ligji për
17 Nxjerrjen e Informacioneve Publikisht shikon edhe nëse
18 nxjerrja e këtij informacioni ka shkelur apo jo edhe të drejta
19 të tjera të njeriut, pra edhe këto duhen mbajtur parasysht.
20 Kushdo që e nxjerr publikisht, qoftë përmes publikimit të një
21 artikulli, apo përmes nxjerrjes së drejtpërdrejtë.

22 Autenticiteti i informacionit që nxirret në shumicën e
23 ligjeve tani, kjo bën pjesë në besimin e arsyeshëm të
24 individit. Pra nuk është një proces tërësisht objektiv që do
25 ta ndërmernte dikush me përvojën e mjaftueshme.

1 Py. Pra, nëse bëjmë vlerësim të besimit të arsyeshëm, duhet
2 parë individi, pra rrethanat e individit, nëse do të ishte e
3 arsyeshme të themi që ai kishte besimin e arsyeshëm. Pra e
4 keni fjalën për atë individ?

5 Pë. Po, po sigurisht, në atë rast.

6 Py. Ju përmendni gjashtë parimet. Keni përmendur dhe ligjin
7 britanik për Nxjerrjen e Informacioneve Publikisht. Dua që t'i
8 marrim me radhë këto parime. Por a do të thoshit se
9 informacioni që ju keni përmendur në raportin tuaj duke u
10 mbështetur në legjislacionin britanik, gjithsesi përfaqëson
11 parimet e njohura gjerësisht edhe jashtë Britanisë së Madhe?

12 Pë. Po.

13 Py. Po të shohim parimin 1 dhe kur t'i shikojmë parimet dua
14 që të mbajmë parasysh që të mos t'i krahasojmë me faktet e
15 çështjes tonë gjyqësore këtu, por të qëndroni vetëm tek
16 parimet përgjithësisht. Po të shohim parimin numër 1,
17 paragrafi 33 i raportit tuaj, çfarë do të thoshit ju se do të
18 përbënte vënien në lëvizje për mbrojtjen?

19 Pë. Më duket se nuk e kuptoj mirë pyetjen.

20 Py. Mbase është më mirë të shpjegoni çfarë është parimi numër
21 1.

22 Pë. Atëherë, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut,
23 GJEDNJ, shikohen nxjerrjet publike. Pra jemi në këtë kontekst
24 dhe shikoj nëse ka pasur apo jo rrugë të tjera në dispozicion
25 për të mos dalë publikisht. Pra vënia në lëvizje është të

1 dalurit publik apo jo dhe jopërdorimi i rrugëve të tjera.

2 Py. Dhe vënia në lëvizje - dhe më korrigjoni nëse e kam gabim

3 - do të ishte edhe nëse do të kishte rrugë të tjera në

4 dispozicion, mund të mos kenë qenë praktike apo të suksesshme

5 dhe kjo ka bërë të domosdoshme daljen publike?

6 Pë. Po, mund ta kenë përdorur rrugë të tjera dhe s'ka ndodhur

7 asgjë. I kanë përdorur dhe kanë parë se informacioni është

8 shpërfillur dhe këto ishin në vendin e punës për parime të

9 përgjithshme për shembull në vendin e punës. Ose ke parë të

10 tjerë të cilët i kanë përdorur të njëjtat rrugë të tjerët dhe

11 nuk ka ndodhur asgjë ose mund të jenë sulmuar apo kundër tyre

12 mund të jetë marrë hak pse i kanë përdorur këto. Prandaj dhe

13 kjo është përfshirë dhe në ligjin britanik për daljen, për

14 Nxjerrjen e Informacionit Publikisht.

15 Pra këto janë - duhet që të jenë rrugë të besueshme dhe

16 të jenë në dispozicion të individit. Janë shumë rrethanore dhe

17 kërkojnë një lloj shqyrtimi për të parë se çfarë mendonte

18 individi, si ishte situata asokohe.

19 Py. Pra në mendimin tuaj si eksperte, në rastin hipotetik po

20 ta zëmë se unë do ia kisha dhënë këtë informacion autoriteteve

21 shtetërore apo nëse mund të isha sulmuar apo kritikuar se do

22 kisha bërë një veprim të caktuar, atëherë dalja publike do të

23 ishte e mbrojtur dhe e justifikuar?

24 Pë. Po. Këtu dua të them se në përvojën ndërkombëtare pra si

25 një juriste që ka punuar në Britani, që i është kërkuar që të

1 flasë për sinjalizimin, një prej elementëve të cilat unë kam
2 dijeni është se në vendet e ndryshme - pra po flas këtu para
3 20 vjetësh për mbrojtjen e punëdhënësve, punëmarrësve më falni
4 - po kam punuar edhe në Nigeri, kam bërë seminare aty dhe aty
5 flisnin edhe për kërcënime fizike, s'flisni për mbrojtjen e
6 vendit të punës madje.

7 Pra në vartësi të rrethanave të secilit vend si
8 politikbërësit ashtu dhe individët duhet të shikojnë se cilët
9 janë rrugët e besueshme dhe të arsyeshme që mund të ndjekin
10 njerëzit. Për shembull, në Amerikën Latine disa ligje thonë që
11 mund të përdorësh cilëndo të duash ose t'i drejtohesh
12 autoritetit publik ose të dalësh publikisht sidomos për të
13 luftuar korrupsionin.

14 Py. Dhe po thoni se mbrojtja ndaj, mbrojtja pra nga mungesa e
15 suksesit do të ishte e njëjtë edhe ashtu siç bëhet në vendin e
16 punës?

17 Pë. Po.

18 Py. Kalojmë tani tek parimi numër 2. Ndodhet në paragrafin 34
19 të raportit tuaj. Si e shpjegoni ju interesin publik në
20 nxjerrjen e informacionit? Edhe njëherë ju lutem që të mos
21 mbështeteni tek faktet e çështjes tonë gjyqësore këtu. Por në
22 përgjithësi si do ta shpjegoni ju parimin e dytë?

23 Pë. Pra po më kërkoni që të shikoj paragrafin 4 dhe parimin
24 numër 2 që është interesi publik për informacionin?

25 Py. Po.

1 Pë. Kjo është një prej gjërave që ka dalë në çështjet
2 gjyqësore të GJEDNJ-së që është pavarësia e autoritetit
3 kompetent. Në disa raste është sistemi gjyqësor dhe
4 autoritetet e prokurorisë. Dhe për të parë nëse ka shqetësime,
5 dhe kur ka shqetësime sesi funksionojnë këto sisteme, këto
6 institucione, atëherë vihet në lëvizje mbrojtja për daljen
7 publikisht. Prandaj një prej gurëve të themelit të demokracisë
8 dhe të pavarësisë të gjyqësorit duhet të mbulohej, që ky
9 informacion të dalë, për të mbrojtur këtë. Pra e gjitha ka të
10 bëjë me llogaridhënien, me aftësinë institucionale, mirë-
11 administrimin. Të gjitha këto duhen parë nëse - duhet parë
12 sesi funksionojnë këto institucione. Nëse publiku ka apo jo
13 interes për këtë, është diçka e cila duhet mbajtur parasysh
14 nga gjykata, për të parë nëse ka qenë e arsyeshme apo jo
15 nxjerrja publike.

16 Py. Pra nëse një person ka pasur një besim të arsyeshëm se
17 një institucion i caktuar, një institucionit të caktuar i
18 mungonte pavarësia gjyqësore ose i mungonte pavarësia e një
19 autoritetit të prokurorisë, atëherë dalja publike me këto
20 shqetësime do të mbulohej nga ky parim?

21 Pë. Duhet parë nga këndvështrimi subjektiv-objektiv. Prandaj
22 dhe duhet nga këndvështrimi im pra nëse është një dëshmitar
23 apo diçka tjetër, pra edhe nëse do të kishte këtë besim të
24 arsyeshëm ky person, atëherë mund të ndodhej në pozita më të
25 mbrojtura.

1 Py. Kalojmë tani tek parimi numër 3, ku flasim për
2 autencitetin e informacionit, për të cilin ne kemi folur
3 pjesërisht. Nuk e di a mund të na shpjegoni se çfarë thotë ky
4 parim sa i takon autencitetit të informacionit.

5 Pë. Siç e kam kuptuar unë, siç e kanë trajtuar gjykatat, ka
6 të bëjë me besimin e arsyeshëm të individit, nëse ky person
7 beson në mënyrë të arsyeshme se ky informacion që ai ka është
8 i vërtetë. Natyrisht edhe kjo është një prej gjërave
9 interesante që ka dalë kur ia jep informacionet autoriteteve
10 kompetente. Kur në disa raste diskutimi ka qenë nëse individ
11 duhet ta kishte dhënë këtë informacion apo jo. Pastaj
12 kompetenca dhe dijenia i takon autoritetit. Pra në pozitë
13 dëshmitari, individit nuk i kërkohet që të vërtetojë një krim
14 të themi, por thjesht të japë informacionin. Pra në këto raste
15 duhet parë dhe pozita e personit çfarë njohurish prej eksperti
16 ka dhe nëse, mbase nuk i di të gjitha, sepse i lejohet
17 individit ta ketë gabim, të gabojë d.m.th., por duhet të
18 gabojë në sinqeritet.

19 Py. Nëse ky person ka besuar në mënyrë të arsyeshme se
20 informacioni, materiali në fjalë ka qenë autentik, po t'i
21 kthehemi asaj që thatë ju atëherë duhet që, do të na duhet që
22 të kryejmë një analizë të gjerësishme të kësaj, po edhe mund
23 ta kenë pasur gabim.

24 Pë. Mund ta kenë pasur gabim, lejohet ta kenë pasur gabim. Në
25 të gjitha shoqëritë ka përgjegjësi individit se si e merr dhe e

1 përçon informacionin, po kjo në bazë të njohurive që ka dhe të
2 çfarë lloji ekspertize ka. Kështu është parë në raste të
3 veçanta.

4 Py. Të kalojmë tani tek parimi numër 4, që ju e shikoni në
5 paragrafët 35 deri në 37. Mund të na shpjegoni se çfarë është
6 ky parim?

7 Pë. Është në kontekstin e çështjes gjyqësore Guja, ku ishte
8 një punëdhënës. Punëdhënësi në këtë rast ishte një organ
9 publik. Pra nuk kishte vetëm dëm reputacioni por edhe interesi
10 publik i shërbimit që ofronte punëdhënësi. Dhe kjo zbulon dhe
11 rëndësinë e kalimit të barrës së provës tek pala tjetër. Pra
12 në momentin që ti ke dëshmuar se ke bërë një nxjerrje
13 informacioni për interes publik dhe kjo ka pasur dëmtim dhe i
14 takon organizatës që është dëmtuar që të ketë barrën pra që të
15 dëshmojë se është dëmtuar në bazë të nxjerrjes së
16 informacionit. Pra këtë nuk e parashikon edhe ligji, ti nuk
17 mund të vërtetosh se e ka pasur në mendje punëdhënësi. Prandaj
18 i takon punëdhënësit që të tregojë se kanë vepruar në mënyrë
19 të përgjegjshme dhe kanë vepruar pastaj sinjalizimit.

20 Kjo ka dalë edhe në çështjen gjyqësore Guja se individi
21 në atë rast ishte një punëmarrës i organizatës.

22 Py. Me parimin numër 4 gjithmonë, çfarë njihet si një
23 nxjerrje e mbrojtur?

24 Pë. Edhe njëherë dalim te përkufizimi i çështjes gjyqësore së
25 David [Kaye]. Është diçka në interes publik që mund të

1 shkaktojë dëmtim, keqbërje, shkelje të ligjit dhe mund të jetë
2 edhe shkelje e ligjit administrativ apo mund të jetë dhe
3 detyrim që ka organizata kundrejt. Në sektorin privat janë
4 klientët, por në sektorin publik është popullata, janë
5 qytetarët, pra nëse ka pasur një shkelje apo mund të shkaktojë
6 dëmtim ose ka shkaktuar dëmtim.

7 Pra një prej gjërave që nuk duhet të harrojmë - arsyeja
8 pse duhet të promovojmë, të nxisim sinjalizimin për interesin
9 publik është që të parandalohet dëmi, jo medoemos që të ketë
10 ndodhur dëmi. Prandaj dhe ka ligje për këto informacione kur
11 një individ mund ta nxjerrë një informacion të tillë, kur
12 mendon se mund të shkaktohet dëmtim. Kjo parashikohet edhe në
13 ligjet për mbrojtjen e vendit të punës.

14 Py. Ju përmendët David Kaye, përkufizimin e tij. Nga doli?

15 Pë. Ai ka punuar me Konventën e OKB-së kundër korrupsionit.

16 Nuk ka lidhje me vendin e punës aty, me marrëdhëniet e punës.

17 Thotë që kushdo që sinjalizon kundrejt autoriteteve duhet të

18 jetë i mbrojtur - dhe pjesa shpjeguese e Konventës së OKB-së e

19 bën shumë të qartë që ka të bëjë edhe me korrupsionin. Pra

20 duhen mbrojtur dhe treguesit në këtë rast.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Duke pasur parasysh që po afron ora

22 11.00, unë dua që t'i marr edhe dy parimet e tjera. Dhe nuk

23 mjaftojnë dy minuta për të bërë këtë. Kështu që mendoj se

24 është momenti i duhur për të ndaluar tani.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë

1 pushimin tani. Do të rikthehemi në orën 11.30.

2 Këtu bëjmë ndërprerjen e seancës. Po ndërkohë mund të
3 shoqëroni dhe dëshmitaren të dalë nga salla.

4 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

5 --- Pauza fillon në orën 10.58

6 --- Seanca rifillon në orën 11.30

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
8 silleni Dëshmitaren në sallën e gjyqit.

9 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju
11 lutemi, znj. Myers.

12 Z. Cadman, vazhdoni.

13 Z. CADMAN: [Përkthim]

14 Py. Përpara pushimit, po përfundonim diskutimin e parimit 4
15 për daljen në pension të punonjësve.

16 Ju përmendët kalimin e barrës së provës. A mund të më ri-
17 shpjegoni se çfarë do të thuash me këtë?

18 Pë. Kështu ka funksionuar në vendin e punës në bazë të
19 ligjeve për sinjalizuesit. Dhe kjo tregon se është çështja
20 *prima facie* që duhet të paraqesë Prokurori, pra të paraqesë
21 informacion që është në interesin publik dhe pastaj barra e
22 provës i kalon punëdhënësit, në këtë rast të tregojë që ajo që
23 ka ndodhur nuk ka qenë e padrejtë dhe është bërë në bazë të
24 pavarur, pra për të qenë të qartë.

25 Py. Siç thoni në paragrafin 35, ka pasur një çështje që është

1 nxjerrë një material i mbrojtur dhe personi në fjalë ka pësuar
2 dëm dhe është marrë hak ndaj tij. Po e kaloj në një plan më të
3 përgjithshëm, pra ky subjekt duhet të vërtetonte që është
4 dëmtuar?

5 Pë. Po. Ose dëmtim, ose veprimi që ata kanë ndërmarrë nuk
6 kishte lidhje me nxjerrjen, pra është bërë në mënyrë të
7 pavarur. Për shembull, në BE në direktivën e BE, e kanë bërë
8 të qartë që, sinjalizuesit kanë imunitet penal dhe nëse
9 akuzohen, apo dërgohen në gjykatë, e ka barrë organizata që i
10 dërgon ata në gjykatë që kjo çështje nuk lidhet fare me ta.

11 Py. Po kur lidhet me aktivitetin e sinjalizuesit, duhet të
12 provojnë që ka pësuar dëm? Duke balancuar sigurisht edhe
13 interesin e punëdhënësit.

14 Pë. Testi i dëmtimit është shtjelluar shumë përmes
15 jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të
16 Njeriut. Gjykata ka thënë se, që punëdhënësi të tregojë
17 dëmtimin duhet të tregojë që është i madh, i konsiderueshëm
18 për të treguar përfitimin e nxjerrjes për shkak të interesit
19 publik, është më i madh se sa dëmi që është bërë.

20 Py. T'i kthehemi paragrafit 36, fjalisë së dytë. Pra siç
21 thamë në fillim të dëshmisë tuaj, këtu thoni që varet nga
22 gjykata të vendosë nëse interesi publik është më i madh se
23 informacioni konfidencial. Besoj nga kjo ka dalë ai konstatimi
24 që thatë?

25 Pë. Po. Edhe diçka tjetër që ndoshta është mirë si

1 informacion i përgjithshëm. Kur u pa se nuk kishte ligj për
2 nxjerrjet për interes publik, kërkuan opinion ligjor dhe kjo u
3 gjet në parimin e të drejtës kontinentale. Dhe kjo mund të
4 lidhet me konfidencialitetin, pra konfidencialiteti dhe
5 barazia, ajo që individi e nxjerr kur bëhet fjalë për keq
6 bërje pra, kjo nuk ka të bëjë me konfidencialitetin.
7 Py. Pra, në rrethana kur punëdhënësi, në këtë rast një
8 subjekt tjetër, nuk ka provuar se është bërë dëm për shkak të
9 mos provimit, personi që ka bërë nxjerrjen e mbrojtur mund të
10 mbrohet me interesin publik?

11 Pë. Po.

12 Py. Të kalojmë më tej tek parimi nr. 5. E kemi trajtuar deri
13 në një farë mase. Ai ka të bëjë me besimin e arsyeshëm.
14 Gjithmonë duke iu referuar parimit nr. 5, po shohim paragrafin
15 38 të raportit tuaj, si vlerësohet kjo, në terma të
16 përgjithshme?

17 Pë. Shikohet çfarë ka menduar personi subjektivisht në lidhje
18 me dikë në një pozitë të ngjashme, me mundësi të ngjashme, për
19 të pas qasje në informacion dhe me të njëjtën njohuri.

20 Py. Nga pikëpamja historike, do të ishte e drejtë të shikoje,
21 nga pikëpamja historike nëse ekzistonte besimi i arsyeshëm?

22 Pra, do të ishin këto konsiderata, do të vlenin për
23 vlerësimin?

24 Pë. Po.

25 Py. Siç thatë më herët, po shikojmë parimin 5 të paragrafit

1 38 të raportit tuaj, testi i besimit të arsyeshëm ka
2 zëvendësuar testin e mirëbesimit?

3 Pë. I cili nuk është më pjesë e shumicës së instrumenteve
4 juridike që janë përgatitur dhe zhvilluar deri tani.

5 Py. Pra, një besim i arsyeshëm siç thoni ju në raportin tuaj,
6 ose saktësisë së informacionit në kohën e nxjerrjes? Këtë do
7 të vlerësojë gjykata?

8 Pë. Po.

9 Py. Të kalojmë tek parimi 6, në paragrafin 39 të raportit. Na
10 shpjegoni ju lutem, ashpërsinë e sanksionit që përmendni në
11 fillim të paragrafit 39?

12 Pë. I referohet një nga kriteret që gjykata ua vendosi për
13 të parë nëse -- si një nga elementët është nevoja e
14 ndërhyrjes, pra niveli i sanksioneve të vendosura dhe në qoftë
15 se është i arsyeshëm në rrethanat. Këto janë pjesë e
16 përcaktimit të nevojës në një shoqëri demokratike.

17 Py. Kur shqyrtoni parimin 6, shikoni edhe parimet e tjera,
18 apo e merrni të veçantë?

19 Pë. Jo.

20 Py. Pra, e merrni parasysh atë që keni thënë për parimin 4, 5
21 testi i besueshmërisë dhe 6 ashpërsia e sanksionit?

22 Pë. Po.

23 Py. Zonjusha Myers, nuk kam pyetje të tjera në këtë çast.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që
25 raportin e ekspertës ta paraqesim si provë materiale.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sipas
2 paragrafit 4 të Rregullës 149, mund ta paraqisni vetëm në fund
3 të pyetjeve dhe të kundër pyetjeve. Prandaj po e lëmë për
4 momentin.

5 Zoti Rees, keni ndonjë pyetje?

6 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk ka.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Pace,
8 keni fjalën.

9 Pyetje të palës tjetër z. Pace:

10 Py. Mirëdita zonjusha Myers.

11 Pë. Mirëdita.

12 Py. Unë quhem James Pace dhe do t'ju bëj disa pyetje në emër
13 të Prokurorisë.

14 Në paragrafin 10 të raportit tuaj, ju thoni që
15 përkufizimi më i mirë i një sinjalizuesi, është ai i dhënë në
16 raportin e Reporterit të Posaçëm?

17 Pë. Po.

18 Py. Dhe e përsëritët edhe sot?

19 Pë. Po.

20 Py. E shoh që punonjësja e Gjykatës e ka nxjerrë në ekran
21 raportin tuaj.

22 Z. PACE: [Përkthim] Të shohim paragrafin 10 që fillon në
23 faqen DHN0318 [sipas përkthimit] dhe vazhdon në faqen tjetër.
24 Kalojmë në faqen tjetër që është fundi i paragrafit 10.

25 Py. Aty shikojmë poshtë shënim me numër 13 dhe në fund të

1 faqes citoni raportin e Reporterit të Posaçëm, kështu është?

2 Pë. Po.

3 Py. A e dini që në raportin tuaj dhe sot në mëngjes, ju e
4 keqpërdorët përkufizimin, keqcituat përkufizimin e Reporterit
5 që citoni këtu?

6 Pë. E keqcitova?

7 Py. Po, ju thoni që po riprodhoni përkufizimin dhe aty ka një
8 gabim. Keni dijeni për këtë?

9 Pë. Jo.

10 Z. PACE: [Përkthim] Në këtë rast dëshiroj që të vini
11 brinjë për brinjë këtij dokumenti, raportin e Reporterit të
12 Posaçëm me numër DHN0829 [sipas përkthimit] deri në DHN0312
13 [sipas përkthimit]. Fillojmë në faqen DHN0301 [sipas
14 përkthimit].

15 Py. Pra, këtu në anën e majtë të ekranit, besoj pajtoheni,
16 është raporti që citoni, kështu është?

17 Pë. Po.

18 Py. Dhe ju citoni paragrafin 28 që është në fillim të faqes
19 në anën e majtë?

20 Pë. Po.

21 Py. Tani do të lexoj përkufizimin e dhënë në paragrafin 28 të
22 raportit të Reporterit të Posaçëm, që lexon kështu"

23 "... sinjalizuesi është një person që nxjerr informacion
24 që ai ose ajo, beson në mënyrë të arsyeshme në kohën e
25 nxjerrjes, se është i vërtetë dhe se përbën një kërcënim apo

1 dëm për një interes të posaçëm publik”.

2 Po të shohim riprodhimin e këtij përkufizimi në raportin
3 tuaj, do të shikojmë një dallim të ndryshëm, një diferencë të
4 madhe. Ju përdorni “ose”. E shikoni tani këtë mospërputhje?

5 Pë. Po.

6 Py. A mund të na thoni se si ndryshoi?

7 Pë. Është një gabim në anën time.

8 Py. Pra, besoj se doni ta korrigjoni raportin tuaj, që të
9 pasqyrojë atë që është origjinali, e vërtetë?

10 Pë. Po.

11 Py. Të vazhdojmë të përqendrohemi tek paragrafi 28 i këtij
12 raporti, gjithmonë në anën e majtë të ekranit. Aty shohim se
13 Reporteri i Posaçëm thotë që, “autoritete ndërkombëtare dhe
14 juridiksionet kombëtare miratojnë një mori përkufizimesh të
15 sinjalizuesve”. Pajtoni me mua?

16 Pë. Po.

17 Py. Gjithashtu Reporteri citon përkufizime të ndryshme,
18 pajtoheni?

19 Pë. Po.

20 Py. Në të njëjtin paragraf ai thotë shprehimisht se,
21 përkufizimi që jep është për qëllimin e raportit në fjalë, të
22 këtij raporti pra, pajtoheni?

23 Pë. Po.

24 Py. Me sa ju dini, përkufizimi në këtë raport nuk është
25 miratuar fjalë për fjalë shprehimisht në çdo ligj që do të

1 ishte i zbatueshëm përpara kësaj Gjykate. Është e saktë?

2 Pë. Ju kërkoj ndjesë që nuk e di se çfarë është e zbatueshme
3 përpara kësaj Gjykate, por nuk është miratuar fjalë për fjalë
4 edhe në ligjet e tjera që kanë të bëjnë me sinjalizuesit.

5 Py. Po i kthehemi zbatimit të ligjit në këtë Gjykatë mbas
6 pak. Por përpara kësaj ju pyes nëse pajtoheni me mua që, një
7 mbrojtës i interesit publik apo sinjalizuesit, duhet të
8 bazohet në ligj. Pajtoheni me mua për këtë?

9 Pë. Po.

10 Py. Pak më parë thatë që, nuk jeni njohur me ligjin e
11 zbatueshëm në këtë Gjykatë, është kështu?

12 Pë. Po.

13 Py. Kur përgatitët raportin, a jeni konsultuar me ligjin që
14 rregullon punën e këtij institucioni që është Ligji me numër
15 5/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit?

16 Pë. Jo.

17 Py. Nuk e keni lexuar?

18 Pë. Jo.

19 Py. As mbas përgatitjes së raportit?

20 Pë. Jo.

21 Z. PACE: [Përkthim] Dua që të paraqesim ligjin në ekran,
22 që të zëvendësojë dokumentin që është aktualisht, me
23 SPOE00316093 deri në 00316150. Ju lutem të kalojmë tek neni 3
24 që fillon në faqen 316094.

25 Py. Po ju lë një moment që ta lexoni zonjusha Myers dhe

1 pastaj do të kalojmë në faqen tjetër, se vazhdon në faqen
2 tjetër.

3 Pë. Po.

4 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër.

5 Py. Dhe dëshiroj që të lexoni, ju lutem dëshmitare, deri tek
6 nënparagrafi 4.

7 Pë. Po.

8 Py. Po e lexoj vetë paragrafin 4, sepse mbas tij do t'ju bëj
9 një pyetje. Në paragrafin 4 dhe po lexoj nga neni 3 i Ligjit
10 për Gjykatën dhe ZPS-në. Neni 3, nënparagrafi 4 lexon si më
11 poshtë:

12 "Çdo ligj tjetër i Kosovës, rregullore, ligj dytësor,
13 rregull apo zakon dhe praktikë tjetër që nuk është përfshirë
14 shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohet për organizimin,
15 administrimin, funksionet apo juridiksionet e Dhomave të
16 Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Ky
17 ligj ka epërsi ndaj çdo lloji dhe ndaj të gjithave dispozitave
18 të kundërta apo ndonjë ligji apo rregullore tjetër".

19 Besoj se nuk e keni lexuar?

20 Pë. Jo, deri tani jo.

21 Py. Tani që e lexuat, tani që e keni përpara, besoj se
22 pajtoheni me mua se asnjë raport, ligj apo dispozitë ligjore e
23 cituar në raportin tuaj, gjykohet se është e zbatueshme në
24 këtë institucion, kështu?

25 Pë. Nuk pajtohem patjetër.

1 Py. A mund të më thoni, pse?

2 Pë. Sepse unë po jepja informacion bazuar në njohuritë e mia
3 dhe në profesionin tim dhe në ligjin për sinjalizuesit dhe i
4 referohesha Gjykatës Evropiane të të Drejtës së Njeriut,
5 jurisprudencës së saj.

6 Py. Po jeni udhëzuar për të bërë raportin për këtë çështje?

7 Pë. Po.

8 Py. A ua shpjeguan që kjo ka të bëjë, bëhej fjalë për
9 çështjen që paraqiten në Gjykatën kundër Hysni Gucatit dhe
10 Hasim Haradinaj? Dhe ju i jeni referuar jurisprudencës së
11 Gjykatës Evropiane, jam dakord me ju.

12 Por, raporti juaj i referohet sa më poshtë vijon, ligjeve
13 apo dokumenteve. Dhe pasi e keni lexuar Nenin 3 dhe nën nenin
14 4, pajtoheni me mua se ligji i Kosovës për mbrojtjen e
15 sinjalizuesve nuk zbatohet ligjërisht përpara institucioneve
16 ku ndodhemi sot, kështu?

17 Pë. Bazuar në këto që më treguat, jo, nuk zbatohet drejt për
18 drejtë.

19 Py. Mund të themi të njëjtën gjë për një ligj tjetër që keni
20 cituar, që është akti i Mbretërisë së Bashkuar për nxjerrjen
21 në interesin publik.

22 Pë. Këto kanë të bëjnë me punën time dhe me atë që ka
23 informuar rekomandimet e Këshillit të Evropës, i cili është
24 marrë parasysh nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

25 Py. Pra, as në raportin tuaj, as tani, nuk po sugjeroni që

1 këto ligje janë të zbatueshme në këtë çështje që po

2 diskutojmë, për të cilën ju dëshmoni?

3 Pë. Po.

4 Py. Mund të themi gjithashtu që rekomandimi i Këshillit të

5 Ministrave nuk lidhet me këtë?

6 Pë. Përveçse jurisprudencës së Gjykatës.

7 Py. Pra, bëhet fjalë për jurisprudencën e Gjykatës Evropiane

8 për të Drejtat e Njeriut që interpreton Neni 10, kështu?

9 Pë. Po.

10 Py. Pra, ju citoni dhe direktivën e EU për mbrojtjen e

11 personave që raportojnë shkelje të të drejtës, direktivës apo

12 të drejtës Evropiane, pajtoheni me mua që nuk ka të bëjë me

13 këtë që po diskutojmë këtu?

14 Pë. M'u referua lidhur me ekspertizën time.

15 Py. Pra, për të qenë të qartë, t'i lëmë mënjanë Gjykatën

16 Evropiane, ju citoni parime të cilat duhet të miratohen apo që

17 janë parime të mira pozitive, por nuk po pohoni se ato

18 zbatohen ligjërisht për këtë institucion, do të ishte e drejtë

19 kjo?

20 Pë. Po.

21 Py. Tani t'i kthehemi shkurtimisht nenit 10 të Konventës

22 Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

23 Z. PACE: [Përkthim] Dhe ju lutem, paraqiteni në ekran.

24 Është 104683-104716 [sipas përkthimit].

25 Py. Mbase ju e njihni nenin 10, por duhet ta paraqesim për të

1 gjithë ata që e ndjekin.

2 Z. PACE: [Përkthim] Faqja është 104690, ju lutem.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Pace,
4 ngadalësojeni pak.

5 Z. PACE: [Përkthim] Do përpiqem.

6 Py. Pra, e shohim nenin 10 të Konventës Evropiane për të
7 Drejtat e Njeriut në ekran. Dhe dëshiroj që të lexoj nga neni
8 10, nëneni 2, që i referohet lirisë së shprehjes dhe thotë sa
9 më poshtë vijon:

10 "Ushtrimi i këtyre lirive, meqenëse mbart në vetvete
11 detyra dhe përgjegjësi, mund t'i nënshtrohet formaliteteve,
12 kushteve, kufizimeve apo penaliteteve të tilla siç
13 parashikohen në ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri
14 demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit
15 territorial apo sigurisë publike, për parandalimin e
16 çrregullimeve apo krimeve, për mbrojtjen e shëndetit apo të
17 moralit, për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave të të
18 tjerëve për parandalimin e nxjerrjes së informacionit të marrë
19 në konfidencë, apo për mbajtjen e autoritetit dhe pa anësisë
20 së gjyqësorit".

21 Nuk besoj se nuk pajtoheni me këtë nen?

22 Pë. Jo, pajtohem sigurisht.

23 Py. Më herët përmendëm ligjin Kosovar për mbrojtjen e
24 sinjalizuesve dhe ju u pajtuat se, në veçanti u referova tek
25 ligji i këtij institucioni, se ai nuk zbatohet drejt për

1 drejtë këtu, kështu?

2 Pë. Po.

3 Z. REES: [Përkthim] Kjo është një çështje për ju dhe jo
4 për ta bërë në kundërpyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jam dakord.
6 Po e pranoj kundërshtimin.

7 Z. PACE: [Përkthim] Pyetja u bazua në faktin që
8 dëshmitarja e lexoi ligjin e zbatueshëm.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne e lexojmë
10 vetë ligjin.

11 Z. PACE: [Përkthim]

12 Py. Zonja dëshmitare, pavarësisht se për qëllimet aktuale ne
13 pajtohemi që kjo nuk zbatohet, siç tha edhe Avokati i zotit
14 Gucati, është e --

15 Z. REES: [Përkthim] Ju e miratuat kundërshtimin për këto
16 lloj pyetjesh.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

18 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e kam të qartë, çfarë nuk lejohem
19 të them. Dëshmitarja është pajtuar me mua se bazuar në këtë
20 nen, nuk zbatohet këtu.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ajo u
22 përgjigj përpara se zoti Rees kishte mundësinë të bënte
23 kundërshtimin. Dhe unë e miratova kundërshtimin dhe ajo
24 përgjigje nuk do të merret parasysh nga Gjykata.

25 Z. PACE: [Përkthim] E kuptoj.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ju mund
2 të vazhdoni.

3 Z. PACE: [Përkthim]

4 Py. Pra, lidhur me Ligjin Kosovar për sinjalizuesit, është e
5 drejtë që kjo zbatohet edhe në marrëdhëniet e punës?

6 Pë. Si e kuptoj unë, po.

7 Py. Ai ligj i referohet dhe citoj "personave të lidhur me
8 sinjalizuesit", por në këtë rast duke qenë se përkufizimi i
9 sinjalizuesit ka të bëjë me marrëdhëniet e punësimit, personi
10 i lidhur në një farë mënyre është i detyruar nga kjo

11 marrëdhënie punësimi, jeni dakord me mua?

12 Pë. Jo patjetër. Në qoftë se mund ta shpjegoj. Ideja e
13 lehtësuesit dhe jam dakord se nuk kam studiuar jurisprudencën
14 e të drejtës së Kosovës, por është pjesë e direktivës së re të
15 BE-së, lidhet me personat që ngrenë shqetësime apo që mund të
16 bisedojnë me lehtësuesin dhe nuk është e qartë nëse vetë
17 lehtësuesi duhet të jetë në vendin e punës.

18 Py. A jeni dakord që personi që ndihmon, lehtësuesi, duhet
19 edhe ai të jetë sinjalizues?

20 Pë. Jo. Nuk mund të pajtohem, në qoftë se nuk është testuar.

21 Dhe kjo është brenda direktivës së BE-së. Po, burimi fillestar
22 është një person që punon për organizatën. Ndërsa lehtësuesi
23 lidhet me organizatën, mund të jetë të lidhet, por nuk është
24 testuar, nuk është provuar.

25 Py. Të shohim atë që thotë Ligji i Kosovës.

1 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem paraqisni SPOE00316078 deri
2 në 00316092.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë nuk jam shumë i qartë,
5 Prokurori thotë që ligji nuk është i zbatueshëm dhe tani po i
6 bën pyetje bazuar në këto ligje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të presim se
8 cila do të jetë pyetja.

9 Z. PACE: [Përkthim] Të shohim së pari nenin 3.
10 Py. Tek 1.1 thotë:

11 "Sinjalizues është çdo person që raporton apo nxjerr
12 informacion për kërcënim apo dëm në interesin e publikut në
13 kuadrin e marrëdhënieve të punës në sektorin publik apo në
14 sektorin privat".

15 Pra, në kontekstin e këtij ligji nuk është e thënë që të
16 jetë në marrëdhënie punësimi.

17 Z. PACE: [Përkthim] Të shohim përkufizimin e 1.12.
18 Py. Që lexon si vijon:

19 "Personi i shoqëruar apo i lidhur me sinjalizuesin, është
20 një person që e ndihmon sinjalizuesin apo që mund të japë
21 dëshmi lidhur me sinjalizimin apo me çdo person që mund të
22 dëmtohet për shkak të lidhjes me sinjalizuesin".

23 Pra, lidhja këtu është midis personit dhe sinjalizuesit.
24 Dhe siç pamë më herët, në këtë ligj sinjalizuesi nënkupton
25 marrëdhënien e punës, pajtoheni me mua?

1 Pë. Jo. Unë e lexoj si një person që ndihmon. Nuk është e
2 qartë nëse personi që ndihmon është në atë marrëdhënie pune.
3 Siç mund të jetë dikush që lidhet me një sinjalizues, mund të
4 jetë familje, miq, kolegë apo njerëz jashtë vendit të punës.

5 Py. Pajtohem me ju. Por ajo që unë dua të përqendrohem ka të
6 bëjë me faktin që sinjalizuesi mbetet gjithsesi një person që
7 duhet të jetë në marrëdhënie pune. Jo ai që e ndihmon.

8 Pë. Më fal që ju kundërshtoj, por që mund të japë dëshmi
9 lidhur me sinjalizimin. Për mua këtu këtë përkufizon dhe ky
10 është vetëm mendimi im, që një person që mund të japë dëshmi
11 lidhur me sinjalizimin jo patjetër është në marrëdhënie pune.
12 Mund të jetë i pavarur nga sinjalizuesi. Por që në njëfarë
13 mënyre lidhet me sinjalizuesin.

14 Py. Në rregull. Tani më lejoni t'i kthehem faqes 316087 dhe
15 do të doja të shikonim Nenin 20, paragrafi 2 i ligjit. Do ta
16 lexoj për juve. Ligji thotë që:

17 "Sinjalizuesi që jep informacion, mbështetur në këtë ligj
18 është i detyruar që ta japë informacion dhe të respektojë
19 gjithashtu edhe parimin e prezumimit të pafajësisë të personit
20 të akuzuar dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale
21 dhe për të mos penguar gjithashtu edhe funksionimin e
22 procedurave gjyqësore".

23 Atëherë, sipas ligjit Kosovar personi i cili jep
24 informacion duhet të marrë parasysh ndër të tjera që të mbrojë
25 të dhënat personale dhe të mos cenojë funksionimin e

1 procedurave gjyqësore. A jeni dakord me mua?

2 Pë. Këtë parashikon ligji, jam dakord me këtë.

3 Py. A keni qenë e vetëdijshme për këtë dispozitë specifike
4 për Nenin 20(2) kur keni hartuar këtë raport?

5 Pë. Jo, nuk më është kërkuar që të shqyrtoj ligjin Kosovar.

6 Py. A e kam të drejtë që juve -- ky është ligji që ju keni
7 cituar në raportin tuaj?

8 Pë. Po. Unë e kam rishikuar ligjin, e kam parë këtë, por nuk
9 është se e kam përfshirë në raportin tim.

10 Py. Ju jeni në dijeni të faktit që ligji Kosovar që keni
11 cituar për arsye të tjera, kishte këtë parashikim sa i takon
12 respektimit të dhënave personale, por nuk e keni menduar atë
13 si të rëndësishëm për sa i takon përmendjes në raport edhe se
14 çfarë parashikohet në legjislacionin Kosovar dhe jo.

15 Pë. Jo. Unë e kam rishikuar atë në kuadrin e jurisprudencës
16 së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

17 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë provë nga ekrani,
18 zonja Sekretare.

19 Py. Tani, duke iu kthyer ligjit të vitit 1999 [sipas
20 përkthimit] për Nxjerrjen me Interes Publik në Mbretërinë e
21 Bashkuar, ai zbatohet për nxjerrjen e informacionit nga një
22 punonjës në rrethana të caktuara edhe është një ligj ose akt
23 specifik, apo jo?

24 Pë. Po. Ky është një ligj i cili shtrihet edhe për personat
25 të cilët nuk janë në marrëdhënie zyrtare punësimi. Por nuk

Dëshmitarja: Anna Myers (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 66

1 është e rëndësishme që të shohim apo të japim hollësi lidhur
2 me këtë.

3 Py. Faleminderit.

4 Z. PACE: [Përkthim] Tani zonja Sekretare do të doja që të
5 na shfaqni në ekran dokumentin me numër identifikimi
6 SPOE0031732999 [sipas përkthimit] deri në 00317339. Në qoftë
7 se mund të shohim faqen 317330 ju lutem.

8 Py. Dhe, zonja dëshmitare, do të lexoj një pjesë nga neni
9 43B(3) që është një akt që juve e citoni në raportin tuaj.

10 Pë. Po.

11 Py. Atëherë, ky nen parashikon që:

12 "Nxjerrja e informacionit nuk është një nxjerrje e
13 cilësuar në qoftë se, personi që e bën një nxjerrje të tillë
14 kryen një vepër duke e nxjerrë këtë informacion".

15 Pra, ky akt apo ky ligj i Mbretërisë së Bashkuar i vitit
16 1999 [sipas përkthimit] që po shohim, nuk jep mbrojtje për
17 nxjerrjen e informacionit në qoftë, se personi i cili e nxjerr
18 informacionin kryen një vepër penale duke e nxjerrë
19 informacionin. A është e drejtë kjo?

20 Pë. Po.

21 Py. A keni qenë në dijeni të kësaj dispozite të ligjit kur
22 keni hartuar raportin për këtë çështje?

23 Pë. Po.

24 Py. Dhe cila është arsyeja që nuk e keni përmendur në
25 raportin tuaj?

1 Pë. Sërish, unë po shihja se si është trajtuar kjo çështje
2 nga jurisprudenca e GjEDNj-së, sepse e dija që Gjykata nuk
3 është se do të shikonte në detaje të gjitha parimet dhe të
4 gjitha ligjet që ekzistojnë në të gjithë botën, sa i takon
5 mbrojtjes së sinjalizuesve.

6 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni nga ekrani këtë
7 dokument, zonja Sekretare.

8 Py. Tani do t'i drejtohem rekomandimeve të Këshillit të
9 Ministrave, të Komitetit të Ministrave që juve përmendni në
10 raportin tuaj. Këto janë rekomandime që kanë të bëjnë me
11 sinjalizuesit në vendin e punës, a është e saktë kjo?

12 Pë. Po. Thjesht për ta sqaruar pak më tepër nocionin, fjala
13 "sinjalizues" ka tendencë që të jetë një fjalë goxha
14 joformale. Ndërkohë që ligji për nxjerrjen e informacionit për
15 interesin publik, në 1999 në Mbretërinë e Bashkuar, përfshin
16 një fushë më të gjerë veprimi. Por megjithatë do doja të thoja
17 që, rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të
18 Evropës shikojnë edhe aspektin e sinjalizuesve në vendin e
19 punës.

20 Py. Dua që t'i drejtohem një tjetër ligji ose dispozite
21 ligjore që ju përmendni në raportin tuaj. E kam fjalën për
22 direktivën e BE-së që ka të bëjë me mbrojtjen e personave që
23 raportojnë shkelje të të drejtës së BE-së. A është ky një
24 dokument që juve e përmendni në raportin tuaj?

25 Pë. Po.

1 Py. A është e saktë që kjo direktivë lidhet me personat të
2 cilët raportojnë shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian?

3 Pë. Ka të bëjë me dispozita të atyre të cilat bëjnë veprime
4 të parregullta në mjedisin e punës. Dua ta sqaroj që personi
5 ose sinjalizuesi individual, jo gjithmonë është i punësuar.

6 Py. Kur shikojmë fushëveprimin e direktivës, sa për të
7 sqaruar, pra fusha e veprimit është sinjalizuesit në të
8 drejtën e BE-së dhe specifikohet në direktivë që kryesisht
9 lidhet me aspekte financiare dhe tregtare?

10 Pë. Jo. Direktiva e BE-së kam përshtypje që ishte një habi,
11 sepse së pari thamë që nuk ka bazë ligjore dhe pastaj ka të
12 ngjarë që baza ligjore të jetë shumë e gjerë. Është një bazë
13 ligjore që përfshin çështjen e sigurisë ushqimore,
14 përmbushjes, çështjet bankare, financiare dhe fusha të tjera
15 të cilat janë me interes.

16 Py. Në rregull. Le të shikojmë një dispozitë specifike.

17 Z. PACE: [Përkthim] Dua që të kërkoj shfaqjen në ekran të
18 dokumentit me numër identifikimi SPOE00314896 deri në
19 00314935. Do të shikojmë nenin 2 së bashku. Neni 2 jepet në
20 faqet 314913 deri tek faqja pasuese. Faleminderit zonja
21 Sekretare.

22 Py. Tani shohim pjesën e parë të nenit 2, që thotë "Fusha
23 materiale e veprimit". Do lexoj paragrafin 1, i cili lexon:

24 "Kjo direktivë parashikon standardet minimale të
25 përbashkëta për mbrojtjen e personave që raportojnë shkeljet e

1 së drejtës së Bashkimit Evropian”.

2 Besoj që jeni dakord me mua që shkeljet e më poshtme janë
3 ato shkelje që rregullon apo mbulon kjo direktivë?

4 Pë. Po.

5 Py. Mund të shikoni në këtë faqe që kemi gjëra të tilla si
6 për shembull prokurimet publike, shërbimet financiare, siguria
7 e produkteve, përmbushja, siguria e transportit etj. Është e
8 saktë kjo?

9 Pë. Po.

10 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tek faqja
11 tjetër për të lexuar pjesën tjetër të të njëjtin nen, pra të
12 nenit 2.

13 Py. Mund të shohim që shkruhet, shkelje që kanë të bëjnë me
14 interesat financiare, shkelje që kanë të bëjnë me tregun e
15 përbashkët?

16 Pë. Po.

17 Py. Jeni dakord që kjo është fusha e veprimit të kësaj
18 direktive?

19 Pë. Po, rregullon të drejtën e BE-së.

20 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument zonja
21 Sekretare.

22 Py. Besoj jeni dakord me mua që, informacioni që nxirret nga
23 sinjalizuesi duhet të lidhet me një akt të duhur dhe duhet të
24 bëhet siç duhet në mënyrë që të fitojë mbrojtje për
25 sinjalizuesit?

1 Pë. Siç e shpjegova dhe më parë, mund të mbulojë tregues të
2 akteve të duhura. Ti nuk mund të jesh në pozicion që të -- ti
3 nuk mund të përcaktosh dot në qoftë se ka ndodhur një veprim i
4 pa duhur, thjesht kjo është një gjë që e cila parashikohet nga
5 këto ligje që unë përmenda.

6 Py. Por sipas mendimit tënd kërkesa është që të bëhet
7 sinjalizimi për aktet e duhura, apo jo?

8 Pë. Po. Kur e kemi rrezikun e dëmtimit edhe kur kemi
9 parashikime të tjera.

10 Py. Në qoftë se ne do të shikojmë disa shembuj të
11 jurisprudencës që ju përmendët pak më parë dhe që keni
12 reflektuar edhe ne raport, është çështja Guja. Nuk e di nëse
13 po e shqiptoj siç duhet, se besoj se ju e dini më mirë.

14 Pë. Besoj se kështu shqiptohet.

15 Py. Në çështjen Guja flitet për veprimin ose shkeljen që do
16 të raportonte personi.

17 Pë. Shkelja ose keqbërja në vetvete, është goxha më e gjerë.
18 Edhe gjithashtu mund të përfshijë rrezikun e dëmtimit.

19 Py. Jeni dakord me mua besoj që, interesi publik nuk është e
20 njëjta si me një person ose disa persona të cilët nuk janë
21 dakord me një politikë ose ligj të caktuar, është e saktë kjo?

22 Pë. Sërisht, unë mendoj që kjo është një nocion që deri në një
23 farë mase e kanë trajtuar gjykatat, sepse duhet të shikohet
24 nëse ka tregues për shkelje. Dhe po, jam dakord deri në masën
25 që bëhet fjalë për një pozicion personal dhe në qoftë se unë

1 për shembull, jam i inatosur, i zemëruar me mënyrën se si
2 veprohet nga dikush, kjo nuk mbulohet. Dhe ka fusha veprimi të
3 interesit publik është shumë e gjerë dhe për këtë arsye i
4 takon gjykatës që të bëjë përcaktimin e kufijve. Pra gjykatat
5 kanë hapësirë për të përdorur të drejtën e tyre për të
6 përcaktuar se deri ku është kufiri i interesit publik.

7 Py. Sipas mendimit tuaj, në qoftë se një person ose disa
8 persona nuk janë dakord me një ligj i cili është i njohur...

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Kundërshtojmë. Pyetja është bërë më
10 përpara.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
12 Vazhdoni.

13 Z. PACE: [Përkthim]

14 Py. Zonjusha Myers, unë po thoja këtë që, kur një person ose
15 disa persona nuk janë dakord me një ligj që njihet publikisht,
16 a mund të përdoret ky për të kërkuar mbrojtje të interesit
17 publik ose të sinjalizuesve, ky qëndrim a mund të justifikojë
18 mbrojtjen e sinjalizuesve?

19 Pë. Kjo është një pyetje hipotetike shumë e madhe. Mbase jo,
20 por nuk mund ta përjashtoj tërësisht. Opinioni i dikujt mbi
21 një ligj të caktuar ka më shumë gjasa mund të mos trajtohet,
22 të mos mbulohet nga mbrojtja.

23 Py. Dhe një prej faktorëve të rëndësishëm për këtë është që,
24 një ligj -- ose në qoftë se mund ta them ndryshe, ti nuk mund
25 të sinjalizosh për diçka që njihet?

1 Pë. Nuk jam dakord.

2 Py. Si mund të sinjalizosh për diçka që nuk është mohuar nga
3 institucionet ose nga punëdhënësi?

4 Pë. Mund ta bësh.

5 Py. Si mund të kërkosh mbrojtje për këtë?

6 Pë. Mund ta bësh për dëmtim, pra dhe njëherë domethënë, e di
7 që nxjerrja në interes publik nuk zbatohet për këtë Gjykatë,
8 megjithatë nuk është e rëndësishme që situata të njihet për
9 punëdhënësin sepse individi zakonisht nuk e di se çfarë dinë
10 të tjerët.

11 Py. Dhe në qoftë se punëdhënësi ka bërë deklaratë publike,
12 kjo është e rëndësishme sipas mendimit tuaj?

13 Pë. Po, ky mund të jetë një faktor i rëndësishëm në mënyrë që
14 shqetësimin ta ngrenë diku tjetër. Megjithatë, këto janë
15 faktorë të cilët hyjnë në lojë në shumë çështje të
16 sinjalizuesve edhe në qoftë se ka ndërhyrje të lirisë së
17 shprehjes së dikujt.

18 Py. Sërisht duke ju kthyer asaj që thatë më përpara, por që
19 lidhet me atë çfarë po themi tani, pra duhet që të ekzistojë
20 elementi, le të themi i përvetësimit të asaj çfarë nxirret?

21 Pë. Pra duhet të ketë besim të arsyeshëm të informacionit,
22 besim të arsyeshëm të personit që e nxjerr informacionin apo
23 që e jep informacionin. Atëherë, sa për të qenë e qartë për ta
24 sqaruar, një çështje për të cilën mbase gjykata është në
25 dijeni, është çështja Luxleaks dhe pikëpamja ishte që, nuk

1 ishte e paligjshme marrëveshja tatimore që ishte bërë publike
2 dhe ndërkohë personi i akuzuar u shpall i pafajshëm. Pra
3 thjesht dua të them që, në kohën e bërjes publike të
4 informacionit, nuk konsiderohej nga shumë njerëz apo shumë
5 autoritete që kjo ishte një praktikë e paligjshme.

6 Py. Pra, ju thatë më përpara që duhet të ketë një lidhje me
7 përshtatshmërinë apo jo?

8 Pë. Pra individët që nxjerrin informacionin në mënyrë të
9 arsyeshme besuan që ishte e gabuar praktika.

10 Py. Sot më herët juve iu referuat nxjerrjes publike si opsion
11 bërthamor, apo jo?

12 Pë. Po

13 Py. E përshkruat këtë si më të vështirën për ta menaxhuar,
14 apo jo?

15 Pë. Po

16 Py. Ju gjithashtu thatë që ju keni këshilluar ose këshilloni
17 që të merren parasysh opsionet përpara ndjekjes së interesit
18 publik ose nxjerrjes publike në rastin e kundërshtisë
19 bërthamore?

20 Pë. Po, në kuptimin që duhet të merren parasysh përpjekjet për
21 të ngritur një shqetësim të tillë. Siç e thashë dhe më përpara
22 do të duhet që të shikohet pjesa e besimit të arsyeshëm dhe,
23 edhe ti mund të thuash që unë u përpoqa ose të tjerët janë
24 përpjekur, kështu që nuk ia vlen që të ndjek të njëjtën pistë
25 me këtë informacion të ri që kam.

1 Py. A jeni dakord me mua që nxjerrja publike për këtë opsionin
2 bërthamor duhet të jetë opsioni i fundit?

3 Pë. Jam dakord që do këshilloja për këtë, por jam dakord edhe
4 me këtë që, ju mund ta bëni informacionin publik drejtpërdrejt
5 ndonjëherë.

6 Py. Përpjekjet e arsyeshme për të ngritur çështjen e
7 autoriteteve përkatëse duhet të bëhet përpara se informacioni
8 të bëhet publik, a është e drejtë kjo?

9 Pë. Po ngrini një çështje që ka pasur shumë diskutime dhe
10 debat gjatë procesit të negociatave përpara nxjerrjes apo
11 miratimit të direktivës së Bashkimit Evropian. Ideja është që
12 organizatat duhet të funksionojnë, autoritet duhet të
13 funksionojnë dhe këto janë vende që janë përgjegjëse dhe që do
14 i kërkohet llogari dhe për këtë arsye ne duhet të mësojmë për
15 shqetësimet në kohën e duhur, kështu që siç thuhet
16 shprehimisht në rekomandimet e këshillit të Evropës, nuk është
17 se ka një hierarki dhe varet nga rrethanat. Ajo çfarë për të
18 cilën dhe u ra dakord në fund fare në direktivën e Bashkimit
19 Evropian është që, ju mund të shkoni në mënyrë të
20 drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, por gjithashtu edhe
21 mund të thoni shqetësimin tuaj publikisht. Sigurisht, ka ca
22 kushte që duhet të përmbushen për këtë dhe njëra prej këtyre
23 kushteve është që, ose ju jeni përpjekur ta ngrini këtë
24 shqetësim dhe nuk është bërë asgjë, apo ndoshta rreziku është
25 i lartë dhe për këtë arsye është vendos që të dalësh

1 publikisht.

2 Py. Atëherë, të përqendrohemi pak tek pika që je përpjekur ta
3 ngresh shqetësimin dhe asgjë s'është bërë. Atëherë le të
4 mendojmë për atë çfarë thamë më përpara, por është e
5 rëndësishme që të kemi një lloj lidhje me përvetësimin, apo
6 jo?

7 Pë. Po, duhet të ketë një lidhje me vendimin e
8 papërshtatshëm.

9 Py. A do të ishte e drejtë po të themi që, në qoftë se një
10 person donte ta bënte informacionin publik, atë duhet ta bënte
11 në mënyrën që është më pak, le të themi, më pak e dëmshme?

12 Pë. Do të këshilloja që të kushtohet kujdes në momentin kur
13 nxirret informacioni.

14 Py. Pse do ta këshillonit një gjë të tillë?

15 Pë. Ndonjëherë mund të shkaktosh dëm edhe pa qëllim dhe
16 ndonjëherë nuk e ke idenë se çfarë dëmtimi mund të krijosh në
17 momentin kur e bën informacionin publik. Edhe prandaj ndoshta
18 do të ishte mirë që të diskutohej dhe me individë profesionalë
19 që e kuptojnë nivelin e riskut apo të rrezikut dhe sigurisht
20 ky është një element që gjykatat pa diskutim do ta marrin
21 parasysh.

22 Py. Ky dëmi që përmendni, a është e saktë të thuhet që mbi të
23 gjitha duhet që të marrë parasysh edhe dëmin që mund t'i
24 shkaktohet palëve të pafajshme?

25 Pë. Po.

1 Py. Po fakti që palët e treta të pafajshme mund të dëmtohen
2 nga nxjerrja publike e informacionit, kjo merret parasysh në
3 analizën tuaj dhe a mendoni që është e rëndësishme kur
4 analizohet interesi publik i argumentit ose i mbrojtjes?
5 Pë. Kur më është kërkuar këshillimi ose këshillimi profesional
6 do thoja që, detyra e kujdesit duhet ose përkujdesja do të
7 duhet që të merret parasysh në vendimmarrje. Mendoj që një
8 shembull që është përdorur në ligjin britanik për nxjerrjen me
9 interes publik, është nxjerrja e të dhënave të pacientëve që
10 duhet të mbrohet. Pra kur tregohet se cili është dëmi, një
11 pjesë e tyre mund të tregohet por megjithatë duhet që të
12 shikohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet çështjeve. Por sigurisht
13 që ka detyrë edhe specifike që do të duhet të merren parasysh
14 dhe duhet të respektohen. Dhe njerëzit zakonisht janë gjetur
15 në pozicion ku duhet të shpjegojnë se pse kanë marrë vendimin
16 që kanë marrë dhe këtë shpjegim e kanë dhënë përpara
17 gjykatave.

18 Py. Për t'jua bërë më shumë troç, në mënyrë më të
19 drejtpërdrejtë, fakti që dikush mund të vritet si rezultat i
20 informacionit që e bën publik personi X, a është i rëndësishëm
21 në vlerësimin tuaj në qoftë se bërja e këtij informacioni
22 duhet të bëhet publik apo jo, apo në kuadrin e mbrojtjes së
23 sinjalizuesit?

24 Pë. Rreziku i dëmit duhet të shikohet në dy fusha. Së pari,
25 do të duhej që të bëhet vlerësimi i besimit të arsyeshëm të

1 individit se si do të mund të jetë dëmi, por në qoftë se ju
2 thoni se ndërhyrja është e justifikuar atëherë disa prej, një
3 pjesë e dëmit të gjërave duhet që të paraqitet nga palët që
4 pretendojnë që ka dëm. Dhe kjo është diçka e cila është
5 ngritur në disa çështje të gjykuara.

6 Py. Po jeni dakord me mua që ky është një faktor i
7 rëndësishëm për të bërë vlerësimin në qoftë se dikush meriton,
8 letë themi, mbrojtje apo jo?

9 Pë. Po.

10 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të më
11 lejojnë të nderuar Gjykatës, që të konsultohem pak me kolegët.

12 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

13 Z. PACE: [Përkthim]

14 Py. Faleminderit zonjusha Mayers. Nuk kam pyetje të tjera për
15 momentin.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Kam 2-3 pyetje, të nderuar
17 Gjykatës.

18 Pyetje vijuese nga z. Cadman:

19 Py. Zonjusha Myers, kur keni trajtuar çështjen në qoftë se një
20 individ, atëherë termi që përdorëm ishte ndërmjetësi i
21 sinjalizuesit. Atëherë, informacioni që nxirrej kur vinte nga
22 punëdhënësi i këtij subjekti dhe ia jep informacionin një pale
23 të tretë, a kemi të bëjmë me rastin e ndërmjetësit sinjalizues
24 në këtë rast?

25 Pë. Po.

1 Py. Do të mundohem të jem shumë i kujdesshëm për mënyrën se
2 si do ta formuloj pyetjen. Në qoftë se një punonjës i një
3 autoriteti të caktuar prokurorie e ka nxjerrë informacion për
4 një palë të tretë, atëherë kjo palë e tretë është pjesë po
5 ashtu e këtij përshkrimi ose i këtij termi të ngushtë, apo jo?

6 Pë. Po.

7 Py. Zoti Pace ju tregoi, ju foli për kuadrin ligjor të
8 zbatueshëm apo me ligjin e zbatueshëm. A është e drejtë të
9 themi që raporti juaj ka të bëjë me parimet të cilat janë
10 përgjithësisht të zbatueshme? A jeni dakord që çështjet që
11 keni trajtuar sot janë universalisht të zbatueshme ose me
12 fjalë të tjera janë parime të përgjithshme të zbatueshme,
13 pavarësisht juridiksionit?

14 Pë. Po. Sa për të komentuar për disa nga çështjet e GjEDNj do
15 thoja që një pjesë e mirë e çështjeve të trajtuara nga GjEDNj
16 ka të bëjë me subjektet e prokurorisë edhe për mënyrën se si
17 informacioni është shpërndarë, më shumë se si kanë punuar këto
18 autoritete ose këto organe.

19 Py. Unë më parë ju bëra një pyetje lidhur me David Kaye,
20 konkretisht kur ju bëra pyetje me bazën ligjore për
21 përkufizimin e sinjalizuesve. Ndërkohë kolegu im kaloi një
22 pjesë të mirë të dokumenteve, le të themi të cilat janë
23 dokumente të brendshme. Por kjo është diçka e cila mund të
24 gjendet edhe në Konventën Evropiane e të Drejtave të Njeriut?

25 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përpara se sa të

1 përgjigjet dëshmitarja, kjo nuk ka lidhje, pyetja që bëri
2 kolegu. Sepse raporti që po citon zoti Cadman është një raport
3 i cili ka qenë plotësisht i disponueshëm për Mbrojtjen.

4 Kjo është një pyetje orientuese.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është pyetje
6 orientuese. Por do ta lejoj pyetjen, sepse juve kontestuat
7 deklaratat e David Kaye më përpara. Kështu që, dëshmitare
8 vazhdoni t'i jepni përgjigje pyetjes. Më përpara formulojeni
9 edhe një herë pyetjen.

10 Z. CADMAN: [Përkthim]

11 Py. Duke marrë parasysh atë çfarë thatë deri tani, çfarë baze
12 ligjore, në veçanti sa i takon Reporterit të Posaçëm, cila
13 mendoni që është baza ligjore që mund të zbatohet?

14 Pë. Kemi Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut,
15 Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut që aplikohet për
16 të gjithë personat, sa i takon lirisë së shprehjes dhe të
17 opinionit dhe çështjeve që janë shqyrtuar nga Gjykata. Kjo
18 është një ndër bazat që ka parë Konventën në raportin e vet
19 eksperti, por gjithashtu ka parë edhe Konventën e Kombeve të
20 Bashkuara kundër korrupsionit. Në disa prej ligjeve që kam
21 parë, për shembull në ligjin slloven, agjencia anti-korrupsion
22 merret me kërcënimet në vendin e punës, megjithatë mund të
23 trajtojë dhe çështje të tilla si për shembull korrupsionin.

24 Kështu që, në qoftë se flasim nga pikëpamja e
25 informacionit, të gjithë kanë të drejtën që t'i drejtohen

1 Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut apo Konventës së
2 Kombeve të Bashkuara dhe sigurisht që është dëmi ose kërcënimi
3 për ndëshkim për ta bërë këtë gjë që të pajtohet nga ligje të
4 veçanta, përfshirë këtu edhe ligjet disiplinore për personat
5 në vendin e punës. D.m.th. edhe Organizata e Shteteve
6 Evropiane nuk flet për sinjalizuesit, por flet për persona,
7 d.m.th. me fjalë të tjera, dëmi që pëson një individ i tillë,
8 ka të drejtë që të mbrohet nga kjo mbrojtje, pra nga mbrojtja
9 e sinjalizuesve. Dhe për këtë arsye është marrë edhe pjesa e
10 marrëdhënieve të punës edhe është mbuluar nga mbrojtja që i
11 jepet sinjalizuesve.

12 Py. Kur ju pyeta për mendimin tuaj prej eksperteje, juve
13 thatë që, mbi bazën e ligjit kundërshtimet për ligjin mund të
14 formojnë një bazë, mund të jenë bazë për të përdorur mbrojtjen
15 për sinjalizuesit. Dhe sa i takon besimit të arsyeshëm, në
16 qoftë se ka një besim të arsyeshëm se ligji është i
17 paligjshëm, a mund të bëj kjo bazë për kundërshtimin e ligjit?

18 Pë. Po.

19 Py. Në qoftë se shqetësimi do të lidhej me një politikë të
20 caktuar të Prokurorisë dhe në qoftë se ka një arsye të
21 besueshme që kjo politikë është e paligjshme, a përbën kjo
22 bazë për të kërkuar mbrojtjen sipas ligjit për sinjalizuesit?

23 Pë. Po.

24 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, të nderuar Gjykatës.

25 Është e njëjta natyrë e pyetjeve që unë kam bërë.

- 1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
2 përfundoni pyetjen, zoti avokat.
- 3 Z. CADMAN: [Përkthim]
- 4 Py. Në qoftë se kundërshtimi ka të bëjë me një politikë të
5 Prokurorisë dhe në qoftë se një individ ka një besim të
6 arsyeshëm që politika është e paligjshme, ekspozimi ose
7 nxjerrja në dritë e një politike të tillë, a është e
8 pranueshme, është bazë për mbrojtje për sinjalizuesit?
- 9 Pë. Po.
- 10 Py. Po politikat e paduhura, të padenja?
- 11 Pë. Po.
- 12 Py. D.m.th., në qoftë se kemi politika të paligjshme apo të
13 paduhura, këto mbulohen nga mbrojtja e sinjalizuesve?
- 14 Pë. Po. Është pjesë e natyrës së interesit publik, të
15 informacionit për interesin publik.
- 16 Py. Një pyetje të fundit. Zoti Pace ju foli për rrezikun e
17 dëmit ndaj palëve të treta. Duke iu kthyer edhe një herë asaj
18 çfarë neve diskutuam sot paradite në lidhje me parimin 4, në
19 mënyrë që të mbështetesh tek dëmtimi, a duhet autoriteti apo
20 pala e tretë që të thotë se cili është dëmi?
- 21 Pë. Sigurisht që ka disa detyra, ka disa elemente që do të
22 duhen të respektohen si anëtar i shoqërisë, që të mos
23 shkaktosh dëmtim për anëtarët e tjerë të shoqërisë.
- 24 Megjithatë, në varësi të ndërhyrjes, niveli i riskut të dëmit
25 do të duhet që të dëshmohet nga pala e dëmtuar, në qoftë se

1 bëhet fjalë për informacion për interesin publik.

2 Py. Mendoj se ajo çfarë thatë juve është që, vlerësimi

3 ndryshon në qoftë se ti merresh me një profesionist

4 përkundrejt një personi të thjeshtë, a po jo?

5 Pë. Absolutisht, po.

6 Py. Edhe një pyetje të fundit. Zoti Pace e ngriti më shumë se

7 sa një herë këtë çështje, veprimi i paduhur, i padenjë. Pyetja

8 ime është kjo, ky akt a mbështetet tek besimi i arsyeshëm?

9 Pë. Po.

10 Py. Faleminderit zonjusha Myers, nuk kam pyetje të tjera për

11 juve.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam unë nja

13 dy pyetje dhe mund të kenë dhe anëtarët e tjerë të Trupit

14 Gjykses ndonjë pyetje tjetër. Do përpiqemi që t'i biem shkurt.

15 Pyetje nga Trupi Gjykses:

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju përmendët

17 tre çështje në mbështetje të raportit tuaj, ishte Guja v.

18 Moldavisë, pastaj dhe dy çështje të tjera. Në secilën prej

19 këtyre çështjeve, sinjalizuesi është punëmarrës, kështu?

20 Pë. Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht ju

22 keni mbrojtur idenë e një përkufizimi më të gjerë të

23 sinjalizuesit për të dalë dhe jashtë situatave të

24 marrëdhënieve të punës, për të përfshirë edhe të tjerë. Për

25 këtë jam në dijeni. Pyetja ime është, ky përkufizim i zgjeruar

1 i sinjalizuesve, a është përqafuar nga ndonjë gjykatë e
2 brendshme apo ndërkombëtare, në arritjen e një aktgjykimi?
3 Pë. Nuk dua të tregohem e vështirë, por nga që ka shumë ligje
4 të ndryshme të cilat zbatohen për individët që nuk janë nga
5 qendra e punës, ajo që është kuptuar, jo kufizuar por kuptuar,
6 është që sinjalizimi shpesh është brenda për brenda
7 organizatës, pra burim informacioni brenda organizatës.

8 Por, duke pasur parasysh se ç'po ndodh me direktivën e
9 BE-së dhe rekomandimet që Këshilli i Evropës u ka dhënë
10 entiteteve të ndryshme, nevoja është që të sigurohet
11 qarkullimi i lirë i informacionit dhe sinjalizuesit në
12 përgjithësi, kuptohen që janë në qendrën e punës, pavarësisht
13 që nuk është përkufizuar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, e kuptoj
15 që janë në qendrën e punës. Por unë ju pyeta konkretisht, a ka
16 çështje gjyqësore në jurisprudencën e brendshme apo
17 ndërkombëtare kur është përdorur ky koncept i zgjeruar si
18 pjesë e vendimit?

19 Pë. Jo. Me sa kam unë dijeni.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë këtë
21 pyetje kisha. Nuk e di kolegët.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit Gjykatësi
23 Smith. Kam disa pyetje lidhur me Direktivën 2019/1937. Dua të
24 kuptoj objektin e direktivës.

25 Dhe siç e shohim nga neni 3, mund ta nxjerrim edhe në

1 ekran, por me siguri ju e njihni shumë mirë. Unë po lexoj:

2 "Kjo Direktivë nuk cenon rregullat e brendshme për -- pra
3 nuk cenon zbatimin e ligjeve të BE-së apo ligje të tjera të
4 brendshme, lidhur me sa më poshtë:

5 "që është mbrojtja e informacionit të klasifikuar".

6 Pastaj në hyrjen e kësaj direktive, në paragrafin 25
7 thuhet që:

8 "Kjo Direktivë nuk cenon mbrojtjen e informacioneve të
9 klasifikuara të cilat ligjet e BE-së apo ligje apo dispozita
10 administrative zbatohen në Shtetet Anëtare, ku kërkohet për
11 arsye ligjore që të mbrohen nga shikimi i pa autorizuar".

12 Pra, ju vetë thatë që ka pasur një debat, një diskutim
13 shumë të madh për këtë direktivë. A ju kujtohet pse
14 informacioni konfidencial nuk është përfshirë në këtë
15 direktivë?

16 Pë. Unë nuk jam juriste e BE-së, por me sa kam kuptuar unë
17 është që, siguria kombëtare nuk është në kompetencën e BE-së.
18 Është çështje kompetencash këtu, nuk është çështje përjashtimi
19 i një fushe të caktuar konfidencialiteti, sepse
20 konfidencialiteti thotë që ke mbrojtje, për shembull nga e
21 drejta penale civile. Pra, nuk mund të hapim padi në gjykatë
22 apo të procedojmë për shkelje të sekreteve tregtare, për shkak
23 të kësaj dhe gëzon mbrojtje nëse ajo që thua është në
24 interesin publik.

25 Pra, është thënë aty se, konfidencialiteti dhe fshehtësia

1 e biznesit nuk është diçka të cilën kjo direktivë e mbron. Pra
2 këtu bëhet fjalë për sigurinë kombëtare dhe më duket se ka një
3 paragraf ku thuhet aty që, shtetet anëtare mund ta zgjerojnë
4 më tej.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua t'ju ndaloj këtu.
6 Siguria Kombëtare është në Rregullin 3.2. Unë e kam për 3.3,
7 për informacionin e klasifikuar.

8 Si e mendoni ju është "informacioni i klasifikuar"?
9 Pë. I klasifikuar është një informacion i shënuar si i
10 klasifikuar, siç e kuptoj unë dhe kjo ndryshon shumë, për
11 shembull nga Britania e Madhe në fakt, nga sistemi ynë ku ka
12 të bëjë me fshehtësinë. Ne s'kemi klasifikim faktikisht. Pra
13 direktiva përpiqet që të mbulojë të gjitha shtetet anëtare, si
14 ato që kanë sistem klasifikimi, si ato që kanë sekretin
15 zyrtar.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nëse kalojmë tani në
17 jurisprudencën e GjEDNj. A e pranoni që ka një interes
18 legjitim publik për mbrojtjen e identiteteve të dëshmitarëve
19 të brendshëm edhe punonjësve të policisë?

20 Pë. Po.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A do te ishte në interesin
22 publik mbrojtja kundër konfidencialitetit për hetimet penale
23 që s'kanë përfunduar?

24 Pë. Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe kur një

1 individ është në marrëdhënie pune me policinë, një person i
2 cili pretendon se është sinjalizues, është ose punonjës
3 policie i tanishëm ose i mëparshëm, a do thoshit ju që
4 mbrojtja e sinjalizuesve e përfshin nxjerrjen e identiteteve
5 të dëshmitarëve dhe të punonjësve të policisë, në këtë rast
6 sinjalizimi?

7 Pë. Po. Pra po thoni individ i që e nxjerr këtë, është pjesë e
8 kësaj organizate dhe i ka këto detyra?

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Jo, po thosha, një punonjës
10 policie i tanishëm apo i mëparshëm, a mund t'ia nxjerrë
11 publikut identitetin e një informatori të policisë, apo të një
12 dëshmitari konfidencial?

13 Pë. Jo, kjo duhet marrë shumë seriozisht.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Një individ që nuk është në
15 marrëdhënie pune me policinë apo me një autoritet të zbatim të
16 ligjit në përgjithësi, merr apo arrin të ketë në dorë
17 informacione që kanë të bëjnë me identitetin e dëshmitarëve
18 apo të informatorëve të policisë, objekti i mbrojtjes së
19 sinjalizuesit, e mbulon edhe këtë person që e zbulon
20 identitetin?

21 Pë. Unë nuk mendoj se i mbulon të gjitha rastet dhe kemi
22 pasur disa raste të tilla. Diskutimi në përgjithësi kalon nga
23 Po-ja, pra po, nuk është mirë. Pra jam dakord që nuk
24 përfshihet nga objekti i mbrojtjes, por duhet parë nëse është
25 shkaktuar apo jo dëm. Por pajtohem me ju që këto lloj

1 çështjesh nuk janë të pranueshme për gjykatat si nxjerrje e
2 mbrojtur.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të kaloj tani tek natyra
4 e informacionit të nxjerrë. Besoj se mund të pajtohemi se
5 natyra e informacionit të nxjerrë, është një faktor tejet i
6 rëndësishëm, që ka lidhje shumë me faktin nëse gëzon mbrojtje
7 apo jo, personi që nxjerr informacionin?

8 Pë. Po.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në çështje gjyqësore të
10 cilat ju i keni përdorur si bazë, Gjykatësi Smith sapo i
11 përmendi, janë Guja, çështja Heinisch kundër Gjermanisë dhe
12 çështja e tretë. A i kam kuptuar unë saktë se, paditësit në
13 ato çështje gjyqësore kanë nxjerrë informacion që nuk mund të
14 plotësojë kushtet apo të përshkruhet si informacion i cili
15 nxjerr përmbajtjen e një hetimi penal konfidencial të
16 papërfunduar akoma?

17 Pë. Ju kërkoj ndjesë, nuk jam e sigurt. Në momentin kur
18 ndodhi nxjerrja e informacionit nga Guja, më duket se hetimi
19 ishte pushuar, por ishin letra që flisnin për një çështje dhe
20 dukej se kishte interferencë me një vendim që kishte të bënte
21 me atë çështje.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në paragrafin 3 të vendimit
23 të çështjes Guja, gjykata thotë:

24 "Se paditësi ka prezantuar shkelje të të drejtave të tij
25 si pasoje e rrëzimit nga Prokuroria e Përgjithshme, -- si

1 pasojë e heqjes nga puna nga Prokuroria e Përgjithshme për
2 shkak se kishte nxjerrë dy dokumente të cilat, sipas mendimit
3 të tij, tregonin ndërhyrje nga një politikan i nivelit të
4 lartë në një çështje penale të pa përfunduar”.

5 Tani, në vendimin për çështjen Guja, nëse unë nuk e kam
6 gabim, nuk duket se paditësi në një moment ka nxjerrë
7 informacion që nxirrte përmbajtjen konfidenciale të një
8 hetimi.

9 Pë. Ai ka nxjerrë letrat. Nuk e di se çfarë hollësi ka pasur
10 në ato letra, por nga ajo që lexuat ju dhe nga ato që ka thënë
11 Guja, ato do të kishin hollësi për një hetim të papërfunduar.
12 Por unë vetë nuk e di se çfarë thuhej në ato letra.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A jeni në dijeni të ndonjë
14 vendimi të GjEDNj ku kjo Gjykatë ka konstatuar shkelje të
15 nenit 10 të konventës në lidhje me nxjerrjen publike të
16 identiteteve të dëshmitarëve të mbrojtur apo të informatorëve
17 të policisë apo të përmbajtjes të një hetimi penal të
18 papërfunduar?

19 Pë. Nuk jam në dijeni.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit shumë,
21 Gjykatësi Smith.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni pyetje
23 Gjykatësi Mettraux?

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]
25 Faleminderit. Mirëdita zonjusha Myers.

1 Pë. Mirëdita.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]

3 Pra, mesa kuptoj unë, ju zonjusha Myers, i kërkoni këtij Trupi
4 Gjykses që të përdori përkufizimin më të përgjithshëm për
5 sinjalizuesit siç është ai David Kaye, që nuk mbështetet vetëm
6 te kriteri që, personi që nxjerr informacionin të ketë qenë
7 punëmarrës i institucionit?

8 Pë. Unë po them opinionin tim që mund të merret parasysh nga
9 Trupi Gjykses.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] A e
11 pranoni dhe ju vetë që, qëndrimi juaj nuk është në përputhje
12 me atë që ka mbajtur Gjykata Evropiane për të Drejtat e
13 Njeriut, e pranoni?

14 Pë. Po, e pranoj. Kur kam parë çështje gjyqësore, kur janë
15 marrë me aspekte të tjera, pra nuk i kanë ndjekur me doemos
16 kriteret e çështjes Guja. Kam parë disa prej elementëve, por
17 jo të gjitha.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Dhe
19 në fakt të gjitha çështjet që kanë pasur rezultat të
20 suksesshëm sa i takon sinjalizuesve që kanë pretenduar, që
21 kanë qenë në marrëdhënie pune, për shembull janë Guja, Bucur,
22 Heinisch, por ka pasur edhe një varg çështjesh gjyqësore të
23 cilat ishin për zyrtarë shtetëror.

24 Pë. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Dua

1 që të tregohemi të drejtë edhe me ju. A jeni në dijeni të një
2 udhëzuesi për nenin 10 që po përgatitet nga Sekretaria e
3 Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jeni në dijeni të
4 këtij dokumenti?

5 Pë. Po, jam në dijeni, por s'e kam lexuar.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Do
7 t'jua them, por që të tregohem i ndershëm nuk është një
8 dokument me vlerë ligjore, por është përgatitur nga Sekretaria
9 e Gjykatës. Në paragrafin 380 thuhet:

10 "Së pari, statusi i sinjalizuesit medoemos kërkon një
11 marrëdhënie në qendrën e punës". Pra marrëdhënie pune.

12 Ju vetë, a jeni në dijeni të kësaj, të paktën siç e ka
13 kuptuar Sekretaria e GjEDNj?

14 Pë. Ka një çështje gjyqësore, që unë nuk e kam përfshirë këtu
15 dhe mund të mos ta përmend, por është çështje e një OJQ-je që
16 ishin konsideruar që nuk i mbulonte kjo, por ishin 6 gjyqtarë
17 që nuk pajtoheshin me vendimin e gjykatës në atë rast.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Me
19 sa kuptohet ligji e ka të kufizuar sinjalizuesit në rastin që
20 janë në marrëdhënie pune.

21 Pë. Po, marrëdhënie pune.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Kam
23 një pyetje dhe nëse mendoni se nuk bie në objektin e
24 ekspertizës suaj, mund të ma thoni këtë gjë. Por, duke qenë që
25 na kërkon që të ndjekim këtu përkufizimin e David Kaye, mbi

1 çfarë baze ligjore propozoni ju se mund të përfshihet në këtë
2 juridiksion?

3 Pë. David Kaye po shqyrtonte Konventën e OKB-së kundër
4 korrupsionit dhe gjithmonë -- prandaj dhe ai nuk i referohet
5 marrëdhënieve të punës.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Por
7 besoj se e kuptoni që konventa kundër korrupsionit nuk është e
8 zbatueshme në Kosovë, jeni në dijeni?

9 Pë. Nuk jam në dijeni. Nuk e kam parë listën e të gjitha
10 traktateve të nënshkruara.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Dhe
12 plus që kjo konventë jo medoemos kërkon që të përkufizojë
13 sinjalizuesit, por të përkufizojë personat që kryejnë -- të
14 kufizojë aktet e korrupsionit.

15 Pë. Po, po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Nuk
17 jep një përkufizim të sinjalizuesit.

18 Pë. Jo, nuk jep. Por megjithatë ka shumë ligje të cilat në
19 vetvete nuk quhen ligje për sinjalizuesit, por ofrojnë
20 mbrojtje për sinjalizuesit.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]
22 Atëherë si do të sugjeronit ju, si ka lidhje ky përkufizim me
23 juridiksionin këtu? Megjithatë, më thoni nëse kjo nuk ka
24 lidhje me ekspertizën tuaj, mund të mos përgjigjeni.

25 Pë. Unë nuk mendoj se mund të jap përgjigje që dalin jashtë

1 opinionit tim, në atë që kam shkruar. Ndihma për sinjalizimin
2 dhe fakti që gjykata do të merret me një sinjalizim që vjen
3 nga jashtë edhe mund të mos ta quajë sinjalizim. Mbase kjo
4 mund ta ndihmonte gjykatën që ta shikonte më tej këtë çështje.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]
6 Nëse e kam kuptuar gabim ju kërkoj ndjesë, por ju i kërkon
7 këtij Trupi Gjykses që të përdorë një përkufizim të
8 sinjalizimit që nuk përfshin kriterin e mirëbesimit, kështu?
9 Pë. Që të mos shihet mirëbesimi në atë mënyrë siç -- po,
10 duhet parë nga këndvështrimi i besimit të arsyeshëm për të
11 vërtetën.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Ky
13 përkufizim që ju e keni parashtruar, është më i gjerë në
14 natyrë se ai që është ndjekur nga GJEDNJ në çështjet Guja dhe
15 Heinisch. E pranoni?

16 Pë. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Të
18 supozojmë për një çast se zbatohet kriteri i mirëbesimit,
19 pavarësisht që unë e di që ju nuk e preferoni këtë gjë. Dua
20 t'ju lexoj një pasazh nga vendimi i Heinisch në paragrafin 80,
21 ku Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është bazuar tek
22 Rezoluta 1729 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të
23 Evropës.

24 Së pari dua t'ju pyes, a jeni familjarizuar me këtë
25 rezolutë?

1 Pë. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]

3 Kështu ka thënë gjykata:

4 "Sinjalizuesi duhet të konsiderohet se ka vepruar në
5 mirëbesim me kusht që ai ose ajo, të ketë pasur baza të
6 arsyeshme për të besuar se, informacioni që ka nxjerrë është i
7 vërtetë edhe pse më pas zbulohet se nuk ka qenë i vërtetë dhe
8 me kusht që ai ose ajo të mos ketë pasur ndonjë objektiv të
9 paligjshëm apo jo etik".

10 A pranoni që ky është përkufizimi që është ndjekur nga
11 gjykata, për sa i takon mirëbesimit në atë rast?

12 Pë. E pranoj që kjo ka qenë në çështjen Heineisch dhe besoj
13 se ka qenë ky besimi i arsyeshëm për të vërtetën në cilën ato
14 janë fokusuar. Heineisch ka thënë që, nuk kishte një objektiv,
15 një qëllim të paligjshëm.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Por
17 e pranoni besoj se në jurisprudencën e GJEDNJ, një prej
18 kritereve për zbatimin e mbrojtjes së sinjalizuesve, është që
19 sinjalizuesi të ketë baza të arsyeshme për të besuar se
20 informacioni që ka nxjerrë ka qenë i vërtetë?

21 Pë. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Një
23 gjë tjetër që dua të them dhe nëse ju mendoni se nuk duhet t'i
24 përgjigjeni, mund ta thoni këtë gjë. Por a e njihni nocionin e
25 shpërdorimit të të drejtave? E kam fjalën për jurisprudencën e

1 GJEDNJ, e njihni?

2 Pë. Jo, s'e kam ekzaminuar me shumë hollësi. Të paktën sa i
3 takon jurisprudencës.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] A
5 jeni në dijeni se çfarë nënkupton ky koncept? Për nenin 17 të
6 Konventës?

7 Pë. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] A
9 është e drejtë, do të thosha, që ky koncept përcaktuar nga
10 gjykata, ushtrimi i dëmshëm i të drejtës në atë mënyrë që
11 duket qartë që nuk përputhet, apo bie ndesh me qëllimin për të
12 cilën është dhënë e drejta, nuk mbulohet nga konventa? E
13 pranoni?

14 Pë. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Dhe
16 a pranoni po kështu se kjo vlen jo vetëm për lirinë e
17 shprehjes, por mes të tjerash edhe për lirinë e shprehjes,
18 lirinë e fjalës?

19 Pë. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Dhe
21 po kështu për ta konstatuar këtë gjë, sa i takon Nenit 17 të
22 konventës, gjykata shqyrton synimet në bazë të konventës dhe
23 përputhshmërinë e këtyre veprimeve me vlerat dhe qëllimet e
24 konventës? E pranoni që ky është testi?

25 Pë. Unë pranoj që, patjetër kjo do të mbahej parasysht.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Do
2 t'ju bëj dhe unë pyetje hipotetike si koleget e mi. Sipas
3 mendimit tuaj, zonjusha Mayers, një person qëllimi që ka
4 deklaruar është që të diskreditojë, të pengojë apo të cenojë
5 një hetim penal, ky person a vepron në përputhje me parimet
6 dhe vlerat e demokracisë dhe me vlerat e konventës? Sipas
7 mendimit tuaj?

8 Pë. Kur thoni e "deklaruar", do të thotë që e ka thënë vetë
9 ky person që ky është qëllimi?

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Po.

11 Pë. Këto gjëra duhen shqyrtuar plotësisht dhe unë mendoj që
12 ky është një faktor që patjetër duhet mbajtur parasysh nga
13 Gjykata.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Unë
15 po ju pyes juve, jo Gjykatën. Ju, sipas mendimit tuaj, dikush
16 i cili ka deklaruar që ka këto qëllime, nga ato që unë i
17 përmenda, veprimet e tij a do të ishin në përputhje me
18 demokracinë dhe me vlerat themelore të konventës?

19 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a nuk ka lidhje
20 dhe kjo me faktin nëse hetimi penal është i ligjshëm, i
21 paligjshëm, i përshtatshëm, i papërshtatshëm? Duhet të jetë më
22 specifik.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]
24 Zoti Rees, nëse ju do të doni t'i bëni pyetje, do t'ju jepet
25 mundësia që edhe ju të bëni pyetje. Hë për hë dua që zonjusha

1 Myers t'i kthejë përgjigje pyetjes.

2 Z. REES: [Përkthim] Unë e kuptoj që është e pazakontë që
3 unë të ngre kundërshtim për pyetjen që bën Gjykatësi, por ama
4 këtë po bëj dhe ky është kundërshtimi im. Mua më duket se kjo
5 pyetje varet nga fakti nëse hetimi penal është i ligjshëm apo
6 i paligjshëm, i përshtatshëm apo i papërshtatshëm. Kjo varet
7 nga faktet dhe përgjigja varet nga kjo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ju japim
9 mundësi që t'i bëni ju këto pyetje.

10 Zonjusha Myers përgjigjuni pyetjes ju lutem.

11 DËSHMITARJA: [Përkthim] Unë do të mbështetem tek
12 ekspertiza ime, tek përvoja e gjatë me individë të ndryshëm që
13 kanë dashur të ngrenë shqetësimet e tyre. Mendoj se mund të
14 thonë, të deklarojnë gjëra të ndryshme, por kjo jo medoemos ka
15 qenë qëllimi i tyre. Mendoj që varet nga faktet, duhet të
16 shikosh çfarë ka pas fjalëve që ata thanë, pas diskutimeve të
17 tyre. Sepse acarimi që mund të ketë dikush, kjo është edhe nga
18 përvoja ime, acarimi që ndjen dikush e shtyjnë që të thotë
19 gjëra të cilat jo me saktësi e shprehin qëndrimin e tyre.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]
21 Nëse dikush shpërndan informacion që ka të bëjë me dëshmitarë
22 në një çështje penale, kjo a nuk do të ishte pjesë e testit?
23 Ju kërkoj juve që ta përdorni këtë test, a është kjo në
24 përputhje me demokracinë dhe vlerat themelore të konventës,
25 siç e kuptoni?

1 Pë. Këto janë aspekte të cilat Gjykata duhet t'i shikonte në
2 mënyrë shumë serioze, për të parë nëse vlera e interesit
3 publik të nxjerrjes së një informacioni dhe përfitimi që do të
4 kishte publiku dhe ndërhyrja në këtë të drejtë, varet nga
5 faktet që ju përmendni, aludoni ju.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Siç
7 aluduat pak më parë në përgjigje të një pyetjes sime, mund të
8 ketë më shumë se sa një qëllim që ka një individ që kërkon
9 mbrojtje sinjalizimi.

10 Pë. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]
12 Përsëri ta zëmë në nivel hipotetik, se një person ndjek në një
13 moment -- ka qëllim legjitim, interesin publik dhe një interes
14 të cilin nuk merr mbrojtje nga konventa. Thotë që do të
15 informojë publikun, por njëkohësisht kërkon që të frikësojë
16 dikë, për shembull. Çfarë mbrojtje, do të thoshit ju, do të
17 përfitonte ky person si një sinjalizues? Do të ishte e saktë
18 të thoshim që, ky person do të përfitonte mbrojtje vetëm për
19 aq sa ka interes publik, pra është në përmbushje të interesit
20 publik, apo ju do të thoshit që ky person e merr këtë mbrojtje
21 për sa kohë që merr edhe një qëllim jo legjitim?

22 Pë. Sigurisht që unë pajtohem që mund të ketë më shumë se sa
23 një qëllim. Një prej shembujve juridikisht edhe se si ka marrë
24 zgjidhje kjo, por jo në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e
25 Njeriut, s'e kam parë në këtë kontekst, janë ndryshimet që

1 janë bërë në ligjin britanik për nxjerrjen e informacioneve të
2 interesit publik, ku është hequr mirëbesimi dhe për të pasur
3 dhe diskutimin që mbush kushtet për mbrojtje dhe për
4 diskutimin nëse nga informacioni ka përfituar interesi publik
5 apo jo. Është përfshirë aty edhe një sanksion, ku është thënë
6 që, nëse gjykata mendon se pavarësisht se është nxjerrje e
7 mbrojtur, është bërë në keqbesim, atëherë mund të zvogëlohet
8 sanksioni. Jo, kërkoj ndjesë, mund të zvogëlohet mbrojtja deri
9 në, le të themi në 25 për qind, në varësi të asaj që vendos
10 gjykata.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes video lidhjes]
12 Faleminderit. Unë kaq pyetje kisha.

13 Faleminderit Gjykatësi Smith.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit Gjykatësi
15 Smith.

16 Kam vetëm një pyetje për ju, zonjusha Myers. Nëse nuk e
17 kam gabim, ju thatë më herët se, mbrojtja e sinjalizuesit i
18 jepet personave që kanë arsye të besojnë për një politikë
19 prokurorie që është e papërshtatshme, kështu?

20 Pë. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime është, si e
22 kuptoni ju politikën e papërshtatshme të prokurorisë në dallim
23 nga politika e pa igjshme? Mund të na jepni një shembull të
24 një politike të papërshtatshme të prokurorisë?

25 Pë. Unë po përgjigjesha në mënyrë të përgjithshme se si

1 prokuroria, por dhe çdo autoritet tjetër për të cilën ka
2 aspekte që ia kërkon ligji, për të cilat i detyron ligji, por
3 edhe aspekte të tjera të cilat janë të politikës, por që
4 s'kanë të njëjtën peshë dhe politika të cilat janë të
5 papërshtatshme, pra mënyra se si zbatohet politika. Ose më
6 saktë, mënyra se si e kanë këtë politikë për të përmbushur
7 këto detyrime ligjore, kjo mbase mund të jetë ajo.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ajo që unë e kam të vështirë
9 gjithsesi për të kuptuar është se, si e kuptoni ju politikën e
10 papërshtatshme në dallim nga politika e paligjshme.

11 Cila do ishte e papërshtatshme nga këndvështrimi juaj, na
12 jepni një shembull, na e shpjegoni me një shembull si e
13 kuptoni ju politikën e papërshtatshme të prokurorisë.

14 Pë. Unë mund të mbështetem vetëm tek përvoja ime, sa u takon
15 politikave nga prokuroria britanike. Mund të jetë cilado prej
16 politikave që zbatojnë juristët, mund të jetë edhe test i
17 interesit publik sepse edhe kjo është një politikë e
18 prokurorisë britanike. Është një test i cili zbatohet për
19 mënyrën se si vepron prokuroria britanike. Mund të
20 kundërshtohet, por do të ishte e vështirë. Por dikush mund të
21 thotë se nuk i zbaton siç duhet, i zbaton në mënyrë të
22 papërshtatshme.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë t'ju bëj një pyetje
24 tjetër në lidhje me këtë, sepse gjithsesi e kam të vështirë
25 për ta kuptuar këtë. Se çfarë kuptoni ju me e

1 "papërshtatshme". Prokuroria sigurisht ka detyrimet e veta
2 ligjore standarde, kështu?

3 Pë. Po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse prokuroria respekton
5 këto standarde ligjore, ka këtu vend, sipas mendimit tuaj, për
6 sjellje të papërshtatshme? Për procedimin e çështjeve, me
7 saktë?

8 Pë. Këtu po hyjmë në hollësi se çfarë është informacioni.
9 Mund të jetë dikush që kundërshton një politikë dhe mënyrën se
10 si funksionon prokuroria. Ky person mund të besojë se kjo mund
11 të cenonte standardet ligjore, varet se si për shembull
12 bisedojmë me dëshmitarin, mund të jetë një politikë se si e
13 bëjnë. Në fakt në krahasim me standardet ligjore, kjo nuk i
14 përmbush dhe kjo mund të merret në shqyrtim nga gjykata në
15 interesin publik do të ishte e papërshtatshme, të konsiderohej
16 nga gjykata si e papërshtatshme.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I premtova
19 zotit Rees mundësinë që të bëj pyetje të cilën e ngriti gjatë
20 kundërshtimit të tij.

21 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk mendoj duke pasur parasysh
22 edhe përgjigjet.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Mbase më lejohet të bëj një pyetje
25 ne lidhje me atë pyetjen që bëri Gjykatësi Barthe, si sqarim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Vetëm një pyetje.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Do përpiqem që të mos përzihem me
4 faktet e çështjes.

5 Pyetje vijuese të mëtejshme nga z. Cadman:
6 Py. Kur kemi të bëjmë me një politikë të papërshtatshme
7 procedimi të prokurorisë, kur kemi një situatë konflikti dhe
8 politika sipas besimit të arsyeshëm të personit, politika pra
9 e këtij autoriteti është diskriminuese dhe ka koordinuar me
10 individë të një ane të konfliktit që mendohet se ka kryer vetë
11 krime kundër njerëzimit në kohë lufte, a mund të përbente kjo
12 për shembull një politikë të papërshtatshme prokurorie që
13 mbase, mundet, në mënyrë të mundshme flasim, do të binte
14 brenda kësaj?

15 Z. PACE: [Përkthim] Para se të përgjigjet dëshmitarja,
16 kam kundërshtim për këtë pyetje. Bie jashtë udhëzimeve që ka
17 dhënë Trupi Gjykes dhe ka dallim se çfarë pyetjesh mund të
18 bëjnë palët dhe çfarë pyetjesh mund të bëjnë Gjykatësit.
19 Kështu që ne mendojmë se është e palejueshme pyetja që bën
20 avokati.

21 Gjithashtu kjo pyetje ka të bëjë me politika të
22 papërshtatshme prokurorie të cilat, siç i kemi dëgjuar nga
23 dëshmitarja, që ajo vetë nuk e kupton vetë se çfarë do të
24 ishte tamam.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta pranoj

1 kundërshtimin. Kjo është një pyetje që thuajse është e
2 pamundur të mbahet parasysh, sepse kërkon fakte të cilat nuk
3 mund të përdoren për shkak të vendimit të mëparshëm. Kështu që
4 kundërshtimin e pranoj.

5 Z. REES: [Përkthim] Nuk dua ta kundërshtoj vendimin e të
6 nderuarit Gjykatës. Por unë e mbështes zotin Cadman në pyetjen
7 e tij.

8 Ne e kuptojmë vendimin për paragrafin 38 më përpara, por
9 Trupi Gjykues i ka bërë pyetje dëshmitares se çfarë janë
10 shembujt e politikës së papërshtatshme të një prokurorie dhe
11 faktikisht në përputhje me paragrafin 32 të vendimit të
12 Gjykatës, mendoj se dëshmitarja mund të përgjigjesh,
13 pavarësisht se nuk dha dot shembull.

14 Por unë e kuptoj vendimin e të nderuarit Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
16 puna se ajo dukej se nuk përgjigjej dot, ne dhamë urdhër që të
17 mos përgjigjet.

18 Z. REES: [Përkthim] E kuptova.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë e
20 kuptuam përgjigjen e saj, ju e kuptuat përgjigjen e saj. Nuk
21 na duhet më.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Desha ta ndihmoj Trupin Gjykues për
23 t'i dhënë një përgjigje pyetjes së Gjykatësit Barthe.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj se ajo
25 dha përgjigjen e vet më të mirë.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Ajo që mbetet është që ne kërkojmë
2 tani që ka mbaruar.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne morëm
4 vendim për shumicën e paragrafëve, jo për numrin 18 që u ngrit
5 nga zoti Pace dhe ju keni rënë dakord edhe këto 5 fjalë që
6 janë -- që fillojnë me fjalën "as" dhe mbarojnë me fjalën
7 "case", çështje.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 raporti i ekspertit merr numrin 2D6.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra merr
11 numrin 2D6. Kemi dhe ca gjëra të tjera të cilat janë përmendur
12 sot. Po ofroni gjëra të tjera, përveç se këtij dokumenti për
13 prova materiale?

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë e thashë këtë, megjithëse kemi
15 përmendur jurisprudencën e GJEDNJ, nuk do të kërkojmë që këto
16 të pranohen në provat gjyqësore. Po kështu ato nuk janë
17 raporte të plota sa i takon një sërë raportesh të tjera, ne
18 nuk i kemi këto. Janë pikat -- mund të jap numrat ERN.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një moment.
20 Zoti Pace e kuptuat pyetjen time, sepse keni dhe ju këtu
21 lidhje. Ka ndonjë arsye pse dëshiron që të jetë i gjithë
22 dokumenti i përfshirë në prova gjyqësore?

23 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Desha që të
24 bëj dallimin këtu për disa dokumente nga që është i paplotë,
25 apo edhe ngaqë nuk ka lidhje. Nëse duam që të pranohen këto

1 ligje nëpër gjyqësor, duhet të jenë në versionet e tyre të
2 plota. Mbrojtja duket për shembull -- bëhet fjalë për ligjin
3 Kosovar dhe aty u përmend vetëm faqja e parë edhe disa pjesë
4 që u përmendën nga Dëshmitarja. Dhe ne mendojmë që kjo nuk
5 është mënyra më e mirë për të vepruar.

6 Në listën tonë të prezantimit kemi versionin e plotë.
7 Nëse të nderuar Gjykatës, duan që të përfshijnë në prova edhe
8 ligje dhe jurisprudenca të cilat publikisht gjenden, ato duhet
9 të jenë të plota.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne përpiqemi
11 që të mos fusim dokumente që janë 120 faqe të gjata, të fusim
12 vetëm një faqe.

13 Z. PACE: [Përkthim] Po, por varet se për çfarë flasim,
14 për shembull dokumentet më të gjata janë ato që kanë të bëjnë
15 me përvojën e dëshmitares.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Ne e thamë se nuk do t'i përdorim
17 më ato dokumente.

18 Z. PACE: [Përkthim] Kështu që të dimë se për çfarë po
19 diskutojmë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] T'i marrim
21 dokumentet me radhë, një nga një.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Dokumenti i parë është DHN0001 deri
23 tek DHN0046. Nuk ka kundërshtim për këtë dokument.

24 Dokumenti tjetër është 0289 deri në 0312, që është
25 gjithashtu raporti i Këshillit Evropian për sinjalizuesit.

1 Pastaj kemi 0614 deri në 0723 që është Konventa e Kombeve
2 të Bashkuara kundër korrupsionit. Edhe atë nuk mendojmë se
3 duhet ta përdorim në tërësinë e vet. Nuk na duhet ta paraqesim
4 si provë, është përdorur si reference.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
6 trajtuar gjatë pyetjeve apo kundër pyetjeve.

7 Z. PACE: [Përkthim] Me sa di unë, jo. Dhe është një nga
8 artikujt që e kundërshtuam sepse fliste për përvojën e
9 dëshmitares.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do ta
11 pranojmë.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Dokumenti tjetër është direktiva e
13 BE 0556 deri në 0561. Version i paplotë. Në qoftë se doni një
14 version të plotë, mund të paraqesim një të tillë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa faqe është
16 direktiva e BE?

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Ndonjë ide nuk është dokument i
18 gjatë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
20 kundërshtim?

21 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtim. Të pranohet
22 në versionin e plotë.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Kemi 0982 deri në 0991. Jam më se i
24 kënaqur t'jua jap në tërësinë e vet, pra një raport të plotë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Pace.

1 Z. PACE: [Përkthim] Mbase mund të na ndihmoni se cili
2 dokument është.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
4 mbrojtja e sinjalizuesve. Nga fundi i listës suaj e keni.

5 Z. PACE: [Përkthim] Kam një numër tjetër ERN për këtë. A
6 është i njëjti si ai DNH001?

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë. Është i njëjti
8 dokument por është dublikatë. Është gabimi im. Është i njëjti
9 dokument.

10 Dhe i fundit është 0579 deri në 0581, që është dokument
11 për nxjerrjen publike. Është dokument mjaft i gjatë. Është
12 Akti për Nxjerrjen.

13 Z. PACE: [Përkthim] Mendoj që, në qoftë se dëshironi ta
14 pranoni ligjin, kërkojmë që të pranohet i plotë. Është në
15 listën tonë të provave. Nuk keni nevojë të krijoni një provë
16 të re.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
18 pranohet i tëri.

19 Z. PACE: [Përkthim] Kaq kishim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të kemi
21 një listë me numrat e provave materiale.

22 Z. PACE: [Përkthim] Mund t'ju ndihmoj unë me listën. Një
23 nga artikujt e aktit për nxjerrjen publike që e kemi përfshirë
24 në listë, është SPOE00317319. Sigurisht Mbrojtja mund ta

1 shikojë dhe mund të thotë nëse është korrekt, pra është numër
2 i saktë ERN. Mund t'ju jap edhe numrin ERN.

3 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
4 këshillohen]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Metoda më e
6 lehtë për ta bërë këtë, meqenëse është oferta juaj dhe ju
7 s'keni kundërshtim për sa kohë që është dokument i plotë. Na
8 dërgoni listën dhe punonjësja e gjykatës do t'i caktojë një
9 numër dhe ne do t'i japim një urdhër me atë të cilin ne do t'i
10 pranojmë.

11 Z. REES: [Përkthim] Ka një çështje që lidhet me këtë që
12 dua ta ngrejë për qëllime sqarimi. Dëshmitarja nuk ka nevojë
13 që të mbahet këtu. Po rri në vendin e saj.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk përfshimë Ligjin numër 06/L-85,
15 ligjin e Kosovës. Edhe ai duhet të pranohet. Do ta fusim të
16 gjithë ligjin.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
18 znj. Myers që ishit sot këtu. Dëshmia juaj mbaroi. Sekretarja
19 do t'ju shoqërojë jashtë nga salla e gjyqit.

20 DËSHMITARJA: Faleminderit shumë i nderuar.

21 [Dëshmitarja largohet]

22 Z. REES: [Përkthim] Shumë shkurt, të nderuar Gjykatës.

23 Diskutimi që u zhvillua në mënyrë laterale sepse ajo
24 është thirrur si një dëshmitare eksperte. Por qëndrimi i
25 përgjithshëm, me sa kuptuam ne, është që nuk do të paraqesim

1 si prova raporte ligjore apo ligje të cilat padyshim për të
2 cilat mjafton një njoftim dhe kur të vijë puna për t'i
3 përdorur, mund të bëjmë kopje të tyre.

4 Nuk ka nevojë t'i paraqesim për shembull gjykime të
5 Gjykatës Evropiane apo instrumente juridikë të cilat janë
6 miratuar nga Parlamenti i Kosovës. Janë çështje që mund t'i
7 përdorim, mund t'ju referohemi kur të vijmë tek dosja
8 përfundimtare dhe deklarata përmbyllëse. Pa pasur nevojë që
9 këto raporte t'i paraqesim si prova për instrumente ligjor.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i
11 marrim parasysh këto dokumente pa i pranuar, por mund të
12 ofrohen nëse dikush dëshiron t'i paraqesë. Ne po tregohemi
13 fleksibël këtu.

14 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj. Por përpara se t'u
15 referohemi, do t'ju njoftojmë dhe do të jenë edhe në dosjen
16 tonë. Për tu ndihmuar ju, mund t'jua vëmë në dispozicion. Por
17 me sa kuptoj dhe shpresoj të kem të drejtë, jemi të detyruar
18 tu referohemi çështjeve që janë pranuar si prova.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, vendimet
20 mund t'i shikojmë vetë dhe i lexojmë vetë ne një çështje që
21 është zhvilluar aty.

22 Pra e kuptoni drejtë zoti Rees, që ta dinë të gjithë.

23 Z. REES: [Përkthim] Jam mirënjohës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranojmë
25 raportin si provë materiale me përjashtim të paragrafit 32, 35

1 [sipas përkthimit], 25 dhe fjalinë e fundit të paragrafit 34,
2 paragrafin 36 vetëm fjalinë e dytë dhe paragrafin 40. Këto
3 janë përjashtimet ndaj pranimit.

4 Paragrafi 18 kemi dhënë vendim, duke qenë se është një
5 raport ekspert, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Haradinaj
6 që të hënën 24 janar, të parashtrojë një version të redaktuar
7 duke hequr paragrafët e përjashtuar. Dhe ky version i
8 redaktuar, do të pranohet si provë, pjesa e dokumenteve.

9 Klasifikimi do të jetë publik.

10 Kaq besoj. Provat e tjera i kemi diskutuar.

11 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni kam diçka.

12 Nga transkripti ju thatë që është hequr paragrafi 25, por
13 është 23 deri në 25, me sa di unë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni të
15 drejtë. E thashë unë gabim. 23 deri tek 25 dhe të tjerat siç i
16 thashë.

17 Mbarojmë sot. Do të kthehemi përsëri në orën 08.00 të
18 mëngjesit, po ua kujtoj edhe njëherë.

19 Zoti Cadman jeni ngritur në këmbë.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Për paragrafin 34, me sa di unë
21 vetëm fjalia e parë është e redaktuar. E dyta, më falni.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fjalia e dytë
23 dhe e fundit.

24 Pra mbarojmë sot deri të hënën.

25 Z. REES: [Përkthim] Të hënën do ta marri në dorë Bowden.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 --- Seanca mbyllet në orën 13.18

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25